

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE

Bruksel, 8.11.2006
SEK (2006) 1383

DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT

Shqipëria - Progres Raporti 2006

Shqip
{KOM (2006) 694 final}

PASQYRA E LWNDWS

1.	Hyrje.....	4
1.1.	Parathënie.....	4
1.2.	Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.....	4
2.	Kriteret politike	5
2.1.	Demokracia dhe shteti i së drejtës	5
2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	10
2.3.	Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare	15
3.	Kriteret Ekonomike	16
3.1.	Hyrje.....	16
3.2.	Vlerësimi sipas kritereve të Kopenhagenit	16
3.2.1.	Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....	16
3.2.2.	Kapaciteti për të përballuar trysninë e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE.....	20
4.	Standardet europiane	22
4.1.	Tregu i brendshëm	22
4.1.1.	Lëvizja e lirë e mallrave.....	22
4.1.2.	Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes	24
4.1.3.	Lëvizja e lirë e kapitalit.....	25
4.1.4.	Doganat dhe tatimet	25
4.1.5.	Konkurrenca.....	27
4.1.6.	Prokurimi publik.....	28
4.1.7.	Ligji i pronësisë intelektuale	28
4.1.8.	Politikat sociale	29
4.2.	Politikat sektoriale	30
4.2.1.	Industria dhe SME	30
4.2.2.	Bujqësia dhe peshkimi	31
4.2.3.	Mjedisi.....	32
4.2.4.	Politika e transportit	34
4.2.5.	Energjia	35
4.2.6.	Shoqëria e informimit dhe media.....	36

4.2.7. Kontrolli financiar.....	37
4.2.8. Statistikat	38
4.3. Drejtësia, liria dhe siguria	39
4.3.1. Vizat, kufiri, kontrolli, azili dhe migrimi.....	39
4.3.2. Pastrimi i parave	41
4.3.3. Drogat.....	42
4.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	43
4.3.6. Mbrojtja e të dhënave statistikore.....	45

DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT

Shqipëria - Progres Raporti 2006

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Që në mars 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ky raport progresi ndjek thujtë të njëjtën strukturë si vitet e kaluara. Raporti:

- përshkruan shkurtimisht marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kritereve politike për anëtarim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kritereve ekonomike për anëtarim;
- shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis*, në përputhje me përparësitë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të Partneritetit Europian.

Ky raport mbulon periodhën nga 1 tetor 2005 deri në 30 shtator 2006. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, ligjeve të miratuara dhe masave të zbatuara. Si rregull, ligjet apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk janë marrë parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë mes të gjitha raporteve dhe lejon një vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Përveç këtyre, janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, Shteteve Anëtare, raporteve¹ të Parlamentit Europian, dhe informacionet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare.

Komisioni nxjerr përfundime duke e konsideruar Shqipërinë bazuar vetëm nga komunikimi i saj mbi zgjerimin², bazuar në analizën teknike që përmban ky raport.

1.2 Marrëdhënies midis BE-së dhe Shqipërisë

Shqipëria po merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit** (pSA).

Shqipëria nënshkroi **Marrëveshje e Stabilizim-Asociimit** me BE-në në 12 qershor 2006. MSA përcakton një kuadër angazhimesh të ndërsjella mbi një rant të gjerë çështjesh politike, tregtare dhe ekonomike.

¹ Për Shqipërinë, raportues është Z. Toomas Ilves

² Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2006-2007.

Pjesët e MSA-së që kanë të bëjnë me tregtinë, vihen në zbatim nëpërmjet një Marrëveshjeje të Ndërmjetme (Përkohshme) ndërkohë që kompletohet ratifikimi i MSA-së. Marrëveshja e Ndërmjetme hyn në fuqi në 1 dhjetor 2006. Dispozitat e bashkëpunimit të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik (TCECA) do të vazhdojnë të jenë funksionale deri në ratifikimin e MSA-së. Shqipëria gjithashtu përfiton nga msa tregtare autonome e dhënë nga BE.

Partneriteti European i rishikuar, që rendit përparësitë që duhet të Adresojë Shqipëria në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, u miratua në janar 2005. Shqipëria miratoi në korrik 2006 një plan për zbatimin e përparësive të Partneritetit European.

Një marrëveshje ripranimi Komunitete Europiane-Shqipëri hyri në fuqi në maj 2006. Në korrik 2006, Komisioni i paraqiti propozimin Këshillit për një mandat për të negociuar marrëveshjen Komunitete Europiane-Shqipëri për **lehtësimin e regjimit të vizave**.

KE i akordoi Shqipërisë **asistencë financiare** me një total prej 45.5 milion EUR në 2006. Shqipëria gjithashtu përfiton nga huat e BEI-s dhe 25 milion EUR si asistencë makro-financiare e KE-së.

2. KRITERET POLITIKE

Ky seksion ekzaminon progresin e Shqipërisë në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagenit që kërkojnë stabilitet të institucioneve garantuese të demokracisë, shtetin e së drejtës, të drejtat njerëzore dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

Parlamenti

Roli i parlamentit si një institucion qendror politik vazhdoi të rritet. Marrëdhëniet midis parlamentit dhe organeve të tjera kushtetuese, veçanërisht Gjykatës Kushtetuese dhe Presidencës, si dhe ndërhyrjet pasuese të këtyre organeve, kanë qenë të duhura dhe efikase. Komisionit Parlamentar për Integrimin European ka qenë shumë aktiv, që ka ndihmuar në rritjen e sensibilizimit rreth procesit të integritimit european në aktivitetet e parlamentit. Puna efikase plenare dhe e komisionit, i lejoi Parlamentit që të përballonte me sukses ligjin për buxhetin 2006. Puna e parlamentit është tashmë më transparente pasi staf dhe pajisje të specializuara po përdoren për të transkriptuar të gjitha seancat plenare parlamentare.

Periudhat e ngërçeve politike në pranverën dhe verën e 2006-ës, penguan përpjekjet e parlamentit të merrej siç duhej me çështjet e reformave të rëndësishme, veçanërisht ato që kërkojnë konsensus të gjerë politik. Klima e dobët politike pengoi punën e grupeve parlamentare për reformën zgjedhore dhe marrëveshjet e ngadalta politike vonuan emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror Zgjedhor. Kjo bëri që të vonohej puna për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së pas zgjedhjeve parlamentare të 2005-ës. Marrëveshja politike e arritur në gusht me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar i dha fund ngërçit në verë. Sidoqoftë, Shqipëria duhet të demonstrojë se ka kapacitetet për të arritur një bashkëpunim politik pa ndërhyrjen e jashtme.

Parlamenti vazhdon të përballlet me mangësi teknike dhe administrative. Buxheti i kufizuar i parlamentit nuk përqendrohet në mënyrë konsistente në detyrat thelbësore. Procedurat dhe pajisjet e votimit akoma nuk garantojnë rezultatet transparente dhe të padiskutueshme. Janë ngritur një sërë komitimesh hetuese

ad hoc, ndonjëherë me mandat të paqartë. Kjo gjë përbën rrezik duplikimi. Transparenca e parlamentit mund të jetë më transparente nëse transkriptohet edhe puna e komisioneve parlamentare.

Në përgjithësi, parlamenti po merr përipër rolin e plotë politik dhe po bën përmirësim të qëndrueshëm në aspektin teknik. Megjithatë, puna efikase parlamentare mbi reformat thelbësore për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, është penguar nga bashkëpunimi i vështirë politik.

Qeveria

Qeveria ka miratuar një plan të rishikuar kombëtar për zbatimin e përparësive të Partneritetit European dhe MSA-së. Ky plan është përpjekja e parë për të përcaktuar një kosto për procesin e integritetit europian, që është i nevojshëm për parashikimin buxhetor. Planit gjithashtu rendit reformat dhe hapat për krijimin e kapaciteteve dhe u ngarkon përgjegjësitë institucionale. Ky plan do të jetë pjesë e një Strategjie Kombëtare të re për Zhvillimin dhe Integritimin (NSDI). Ka filluar puna për zhvillimin e 23 strategjive sektoriale dhe 10 strategjive të ndërthurura (cross-cutting) për NSDI. Akordimet e fondeve për ministrinë e linjës, do të kufizohen në aksionet e përshkruara në 23 strategjitë sektoriale. NSDI do të ushqejë Sistemin e Planifikimit të Integruar (ISP) nëpërmjet të cilit do të akordohen burimet kombëtare dhe të donacioneve. Ky kuadër strategjik dhe operativ mendohet të ndihmojë qeverinë të përmbushë angazhimet për reformat në kuadrin e MSA-së.

Këshilli i Ministrave miratoi ngritjen e Njësive Integrimi në 12 ministri linje. Ngritja e këtyre njësive, përmes të cilave Ministria e Integritetit European do të koordinojë reformat që kanë lidhje me BE-në, është në proces e sipër. Ministri i Integritetit është caktuar Koordinator i Ndihmës Kombëtare IPA.

Stafi i Këshillit të Ministrave është zëvendësuar ndjeshëm me grupe që merret me çështjet e ndërthurura (cross-cutting) drejtpërdrejt nën këshilltarët e Kryeministrit. Kjo strukturë mund të ndihmojë në adresimin horizontal të çështjeve me përparësi të lartë. Janë bërë disa përpjekje për të zgjeruar pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve të reja përtej qeverisjes qendrore deri te aktorët vendorë dhe të shoqërisë civile, për shembull për projekt-ligjin për huat për pushtetin vendor (bashkitë).

Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për të siguruar konsensus më të gjerë dhe shfrytëzimin e të gjithë ekspertizës së disponueshme për reformat. Ekipet e reja horizontale që punojnë drejtpërdrejt për Kryeministrin, jo gjithmonë kanë marrë në konsideratë ekspertizën qeveritare dhe donatore në hartimin e propozimeve legislative, duke rezultuar në hartime të dobëta. Po shtohet numri i institucioneve drejtpërdrejt nën Këshillin e Ministrave, dhe shihet një prirje për vëzhgim të drejtpërdrejt nga ana e Kryeministrit. Ky centralizim ka çuar në marrjen e shumë vendimeve teknike rutinë shumë vendime teknike në nivelin e Kryeministrit, çka ka vonuar aksionet kyçe.

Zbatimi i IPS aktualisht koordinohet nga Departamenti i Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmës së Huaj në Këshillin e Ministrave. Megjithatë, numri i plotë i personelit për Njësinë e Zbatimit të IPS nuk është caktuar akoma, pavarësisht një plani të përmirësuar të stafit. Koordinimi i shëndoshë ndërmjet Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmës së Huaj dhe Ministrisë së Integritetit European do të jetë vendimtar, sidomos në garantimin e mbështetjes së duhur për angazhimet për reformat MSA.

Administrata publike

Qeveria e re ka bërë ndryshime të konsiderueshme në administratën publike. Ndryshimet thelbësore të stafit janë bërë për të adresuar korrupsionin, sidomos në dogana dhe tatime. Portofolet ministrore

janë ndryshuar: për shembull Ministrinë e Rendit Publik dhe e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, janë integruar në një Ministri të re të Brendshme. Gjithashtu shumë Ministri janë ristruktuar për të përmirësuar koordinimin dhe efikasitetin, si në rastin e Ministrisë së Integritit Europian. Tashmë kjo Ministri i ka ambientet e nevojshme.

Megjithatë, punësimi dhe shkarkimi i stafit në disa raste është bërë pa i kushtuar vëmendjen e duhur Ligjit për Shërbimin Civil. Aktet administrative janë firmosur nga zëvendësues të përkohshëm që nuk ishin emëruar zyrtarisht. Të dy këto zhvillime kanë minuar në njëfarë mase sigurinë ligjore të parashikuar nga Ligji për Shërbimin Civil. Futja e strukturave të reja dhe stafit të ri ka çuar në pakësimin tranzitor të kapaciteteve në disa segmente të administratës publike. Shqipëria tashmë duhet që mbi këto ndryshime të forcojë efikasitetin e administratës publike. Kapaciteti i Departamentit të Administratës Publike për vendosjen e strategjive menaxhuese në administratën publike, mbetet i kufizuar. Strukturat e karrierës, planifikimit të karrierës, rrogat dhe menaxhimi i performancës në shërbimin civil dhe shërbimet e tjera publike, mbeten të dobëta. Emërimet politike të nëpunësve të lartë vazhdojnë të jenë në masë, duke e kufizuar rritjen e shërbimit civil në nivel profesioniste të larta.

Sistemi gjyqësor

Ligji i ri për rregullimin e organizimit të gjyqësorit është mirtuar nga Këshilli i Ministrave. Qëllimi ishte përmirësimi i strukturës së karrierës së gjyqtarëve, qartësimi i procedimeve disiplinore dhe caktimi me short (rëndom) i çështjeve të gjyqtarët. Kapacitetet e Zyrës së Administratës së Buxhetit Gjyqësor, janë përmirësuar. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një sistem të ri për vlerësimin profesional të gjyqtarëve të gjykatave të ulëta. Po fillon puna për një ndërtesë të re ku të strehohen gjykatat e rretheve dhe të apelot për krimet e rënda në Tiranë.

Një vendim i Gjykatës Kushtetuese nënvizoi pavarësinë e gjyqësorit. Një ligj i ri me qëllim eliminimin e konfliktit të interesave në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (organi i pavarur që emëron/cakton gjyqtarët) kërkonte që anëtarët e tij, shumica e tyre gjyqtarë, të heqin dorë nga profesioni. Kjo i privoi gjashtë gjykata nga gjyqtarët e tyre, duke e ngadalësuar punën e gjykatave për disa muaj. Më pas, Gjykata Kushtetuese e shpalli jokushtetuese pjesën më të madhe të ligjit të ri.

Transparenca gjyqësore është rritur me publikimin e më shumë vendimeve gjyqësore dhe rezultatet e kontrolleve për shkelje të kodit të procedurës. Ekrane që shfaqin informacione për seancat gjyqësore janë vendosur në hollet e disa gjykatave, si dhe zyrat e gjykatave janë vënë më afër hyrjeve publike.

Shkolla e Magjistraturës i ka zgjeruar programet trajnuese. Ajo mbetet një pikë fokale e rëndësishme për trajnimin fillestar dhe vazhdues dhe është burimi për thujtë prokurorët e rinj dhe gjyqtarët. Strategjia afatgjatë e saj thekson se Shkolla do të jetë e qëndrueshme pa mbështetje donatore, nëse vazhdonte mbështetja nga qeveria.

Është bërë njëfarë progresi në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nëpërmjet ristrukturimit të Shërbimit të Përmbarimit dhe rritjes së nivelit të punonjësve të tij.

Megjithatë, procedimet gjyqësore mbeten të zgjata, të organizuara dobët e me mungesë transparence. Ligji i ri i propozuar për Gjyqësorin nuk adreson tre aspekte: rritjen e pavarësisë dhe mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarëve, rritjen e pagave dhe statusit të stafit administrativ të sistemit gjyqësor (që s'janë nëpunës civilë) dhe ndarjen e duhur të kompetencave midis inspektorave gjyqësore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Dy inspektoratet aktualisht e ndajnë punën në mënyrë

jozyrtare. Dispozitat e propozuara për caktimin transparent të çështjeve do të kërkojnë legjislacion zbatues për të vendosur rregulla objektive. Ende s'është ngritur një sistem për vlerësimin e prokurorëve. Kërkohe zbatimi i ristrukturimit të planifikuar të gjykatave të rretheve për të përmirësuar efikasitetin, por s'ka filluar akoma. Shumë gjykatave ende iu mungon hapësira e nevojshme për salla gjyqi, zyra gjyqtarësh, arkiva dhe pajisje. Bashkëpunimi midis policisë dhe gjyqësorit mbetet i dobët. Shërbimi i Përmbartimit pengohet në ekzekutimin e gjykimeve nga mungesa e fondeve, vendimet e paqarta gjyqësore dhe refuzimi i shumë organizatave qeveritare të përmbushin detyrimet e tyre për gjykimet.

Projekt-Ligji për Gjyqësorin kërkon që të gjithë gjyqtarët e rinj të jenë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, por asnjë hap tjetër nuk është marrë në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nëpërmjet konkurseve të drejta. Zgjerimi i mundësive akademike për studimin e të drejtës, do të kërkojë një sistem të përshtatshëm të kontrollit cilësor. Profesionit të noterit dhe avokatit vazhdojnë të jenë pika të dobëta në sistemin gjyqësor, me pak zhvillime ligjore apo praktike.

Transformimi i Komisionit të Reformës Ligjore nga organ me orar të plotë në organ me orar të pjesshëm, kërcënon pakësimin e kapaciteteve për të siguruar koherencën e ligjeve të reja dhe përputhjen e tyre me kuadret ligjore europiane dhe ndërkombëtare, e për të siguruar pjesëmarrjen dhe informimin e publikut.

Mungojnë përpjekjet e mëtejshme për zhvillimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e dëshmitarëve që ato të garantojnë balancimin e sigurisë së dëshmitarëve vulnerabël me të drejtën për mbrojtje të të akuzuarit. Ka plane për t'i kushtuar një drejtori të plotë policore mbrojtjes së dëshmitarëve, por ende mungojnë burimet e mjaftueshme për zbatimin e plotë të legjislacionit ekzistues. Masave themelore për mbrojtjen e dëshmitarëve, si mbrojtja e dëshmitarëve në gjyq apo përdorimi i ekraneve apo televizionit me qark të mbyllur, nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme. S'është bërë progres në udhëzimet operative për mbrojtjen e dëshmitarëve. Nisur nga fshehtësia dhe ndjeshmëria e mbrojtjes së dëshmitarëve, stabiliteti dhe vazhdimësia e kompletimit me staff në sektor kërkon vëmendje më të madhe.

Një komision i veçantë hetues i parlamentit rezultoi në votim që i rekomandonte Preidentit të shkarkojë Prokurorin e Përgjithshëm. Rrjedhimisht Presidenti e hodhi poshtë këtë rekomandim. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit.

Siguria ligjore është thelbësore në progresin e reformave në Shqipëri dhe është një parakusht i rëndësishëm për një numër detyrimesh nën MSA-në. Në veçanti, miratimi i kuadrove efikase ligjore është i rëndësishëm për tregtinë e suksesshme nën Marrëveshjen e Ndërmjetme dhe MSA-në.

Politika anti-korrupsion

Qeveria ka ndërmarrë masa të vendosura për uljen e korrupsionit, sidomos në shërbimet tatimore dhe doganore ku problemet ishin më të rënda. Kjo gjë adreson një përparësi kyçe të Partneritetit Europian. Shkarkimet në masë janë bërë për të rimarrë kontrollin e departamenteve ku korrupsioni ishte mjaft i përhapur. Kjo rezultoi në disa përmirësime, veçanërisht në dogana.

Qeveria gjithashtu është përpjekur të adresojë korrupsionin duke pakësuar rolin e shtetit në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, nëpërmjet zvogëlimit të stafit të administratës qendrore dhe thjeshtimit të procedurave administrative dhe licencuese. Qeveria ka propozuar reforma në administratën tatimore, prokurimin publik dhe regjistrimin e bizneseve për uljen e korrupsionit dhe përmirësimin e klimës për bizneset.

Numri i zyrtarëve publikë të përndjekur për korrupsion, është rritur. Nga 237 të përndjekur në 2005 dhe 75 në tremujorin e parë të 2006-ës (krahasuar me 171 në 2004), 84 janë ndëshkruar, përfshi zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë. Pavarësisht frikës se ndryshimet e stafëve mund të përdoren si armë politike, butësi nuk është treguar karshi atyre të anëtarësuar në parti në pushtet. Numri i procedimeve disiplinore kundër prokurorëve të korruptuar, është tregues i shkallës së korrupsionit, por sinjal pozitiv që po bëhen hapa për ta luftuar (71 raste që në 2002, dmth. 25-30% i numrit total të prokurorëve në Shqipëri)

Qeveria ka ngritur një Task Forcë Anti-korrupsion të kryesuar nga Kryeministri. Ajo përbëhet nga ministrat e linjës dhe kryetarë të agjencive të ndjeshme qeveritare si për tatimet, privatizimin, licencimin dhe prokurimin publik. Ajo analizon dhe vlerëson problemet e korrupsionit në sektorë specifike dhe formulon përparësi strategjike dhe masa praktike. Stazhi i anëtarëve të saj i jep autoritet që të ndërmarrë ndryshime të vërteta. Grupi Monitorues Anti-Korrupsion është shkruar në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe është riqajtur Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsionit. (DIAC), që operon nën zyrën e Kryeministrit dhe përbëhet nga një drejtor dhe 10 inspektore të cilët analizojnë çështjet e raportuara të korrupsionit në gjitha degët e administratës publike. Ata propozojnë masa administrative ose dërgojnë pëshjetet për hetim penal.

Ligji për Konfliktin e Interesave është amenduar për të adresuar problemet praktike që rezultuan nga zbatimi i ligjit ekzistues. Inspektorati i Lartë për Zbulimin dhe Verifikimin e Pasurive e ka intensifikuar aktivitetin dhe zyrtarët e inspektoratit tashmë janë autorizuar të hetojnë llogaritë bankare të zyrtarëve jashtë Shqipërisë. Task forca e prokurorëve të përzgjedhur dhe oficerëve të policisë gjyqësore e ngritur në gjykatën e rrethit të Tiranës, tashmë merret me çështjet e korrupsionit ashtu edhe me krimet financiare.

Hapa janë marrë për rritjen e transparencës së administratës publike: publikime në internet të urdhrave qeveritare, vendimeve dhe akteve të tjera publike; njësitë e informimit në ministri, linjat e lira telefonike dhe kutitë postare për komentet publike mbi institucionet qendrore.

Shqipëria merr pjesë në dy nisma rajonale anti-korrupsion: GRECO e Këshillit të Europës (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) dhe SPAI (Nisma Anti-Korrupsion të Paktit të Stabilitetit). Zbatimi i rekomandimeve të Raportit Vlerësues të GRECO-s, ka qenë i kufizuar. Qeveria ka ndjekur një qasje të re më tepër se të përdorë kuadrin e Strategjisë Kombëtare Anti-Korrupsion që nuk është përditësuar. Ligji i ri për nxitjen e qytetarëve që të denoncojnë korrupsionin në administratën publike, vë në veprim rekomandimin "whistle-blowing" të GRECO-s. Megjithatë, kjo ka rritur shqetësimet se denoncimet mund të përdoren për larje hesapësh.

Disa masa legjislative të projektuara për të luftuar korrupsionin, janë hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese në bazë të shqetësimeve për të drejtat individuale (për shembull një ligj kundër nepotizmit në administratën doganore dhe tatimore). Një propozim i qeverisë për të hequr imunitetin e anëtarëve të deputetëve me qëllim ndjekjen ligjore për korrupsion, ka mbetur ende varur në parlament pasi kërkohet një shumicë 3/5 parlamentare dhe opozita e kundërshton mbi baza kushtetuese.

Ligje të reja kërkohen nga Shqipëria për të zbatuar Konventën e Ligjit Civil për Korrupsionin dhe Konventën e Ligjit penal për Korrupsionin, Konventën Anti-Korrupsion të OKB-së dhe Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar trans-kombëtar (Konventa e Palermos që përmban dispozita për korrupsionin), zhvillimi i të cilave është vonuar. Shqipëria ende nuk ka legjislacion specifik mbi mitmarrjen nga ana e zyrtarëve të huaj dhe nuk është vend palë në Konventën e OECD-së për Luftën kundër Mitmarrjes nga Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi.

Progresi i qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit është një kusht thelbësor për zbatimin e suksesshëm të MSA-së dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme. Kjo do të kërkojë pasimin e masave të forta fillestare me përpjekje sistematike për të kufizuar shkaqet e korrupsionit nëpërmjet mbushjes së boshllëqeve ligjore, përmirësimit të rrogave, stabilizimit të administratës publike, thjeshtimit të mëtejshëm të procedurave të ndërlikuara e të paqarta administrative si dhe përmirësimi i profesionalizmit i nëpunësve civile. Hartimi dhe miratimi i legjislacionit efikas për reformat sistematike që nevojiten se si të luftojë korrupsionin në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

2.2. Të drejtat njerëzore dhe mbrojtja e minoriteteve

Respektimi i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Shqipëria nënshkroi konventat e mëposhtme në fundin e vitit 2005: Konventa e Këshillit të Europës për Aksion kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Konventa e Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Bllokimin dhe Konfiskimin e Të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit, Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin e Terrorizmit dhe Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë. Megjithatë, këto konventa ngelen për t'u ratifikuar nga parlamenti shqiptar. Shqipëria tashmë ka ratifikuar Protokollin 12 të ECHR (Gjykata Europiane e Të Drejtave të Njeriut) në lidhje me ndalimin e gjerë të diskriminimit dhe nënshkroi Protokollin 14 që amendon sistemin e kontrollit të Konventës.

Shqipëria ekzekutoi të parin nga dy vendime të Gjykatës Europiane për Të Drejtat e Njeriut (ECHR) kundër saj nëpërmjet një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, kodeve të procedurës civile dhe penale të Shqipërisë, ende iu mungojnë dispozitat specifike për t'i dhënë status ligjor sistematikisht vendimeve të ECHR. Vendimi i dytë ECHR ishte kundër Shqipërisë në gusht 2006 në lidhje me rikthimin e pronës. Shqipëria ende nuk ka ratifikuar Protokollin Nr. 13 të ECHR të cilin e nënshkroi në maj 2003. Kjo lidhet me shfuqizimin e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat.

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore garantohen nga ligji shqiptar, dhe qeveria përgjithësisht i respekton. Megjithatë, vënia në zbatim e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në fusha si parandalimi i torturës, të drejtat e të ndaluarve dhe e drejta për një gjyq të drejtë, mbete e mangët. Më poshtë jepen detaje për mangësitë në fusha specifike.

Të drejtat civile dhe politike

Në lidhje me **parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit**, Kodi Penal shqiptar nuk është ende në linjë me standardet e Konventës së OKB-së kundër Torturës, sidomos përkufizimi i Torturës (shihni gjithashtu edhe sistemin e Burgjeve).

Për sa i përket **luftës kundër mosndëshkimit**, ndjekja penale po kryhet sipas ligjit penal dhe kodit të etikës për sistemin e burgjeve për rastet e keqtrajtimit dhe torturës nga ana e organeve të rendit. Në 2005 dhe në tremujorin e parë të vitit 2006, 40 çështje u filluan, 16 u përcollën në gjykatë dhe 3 persona deri tani janë ndëshkuar.

Megjithatë, shumica e përgjegjësve për keqtrajtimin e të burgosurve nuk akuzohen siç duhet për shkeljet e rënda. Ende nuk janë vendosur masa për kompensimin e mjaftueshëm të personave që kanë vuajtur nga keqtrajtimi i organeve të rendit.

Për sa i përket **aksesit në drejtësi**, legjislacioni shqiptar paracakton mbrojtje ligjore falas për të pandehurit të cilët nuk e përballojnë financiarisht një avokat privat. Megjithatë, ky shërbim jo gjithmonë rezulton i dhënë në kohë reale dhe me asistencë ligjore të përshtatshme. Një juridiksion i ndarë nuk është vendosur akoma për gjykimin e të miturve.

Raportime të shpeshta ka pasur për arrestime arbitrare dhe keqtrajtim të homoseksualeve nga policia.

Për sa i takon të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve, janë organizuar kurse të detyrueshme trajnuese mbi të drejtat e njeriut për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë dhe personelin e burgjeve dhe kjo problematikë është përfshirë në kurrikulën e Shkollës së Masgjistraturës. Bashkëpunimi me OJQ-të për monitorimin e burgjeve, është përmirësuar. Një rregullore e re standard që mbulon sistemin e ndalimit para gjyqit, ka pasur përmirësime. Avokati i Popullit (Ombudsman) në Shqipëri ka luajtur një rol gjithnjë e në rritje për mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut në përgjithësi. Objekti i punës së tij është zgjeruar duke përfshirë akses të pakufizuar në burgje. Ministria e Drejtësisë ka braktisur një plan për të ngritur një qendër të re paraburgimi Në Pogradec për të miturit, duke parapëlqyer një në Kavajë, pranë Tiranës, ku qendra do të ishte më e aksesueshme nga anëtarët e familjes.

Megjithatë, pak progres është bërë në përgjithësi për përmirësimin e kushteve në burgje dhe qendrat e paraburgimit. Burimet aktuale njerëzore dhe materiale për menaxhimin e burgjeve, mbeten të pamjaftueshme. Ndërtimi i burgjeve të reja dhe qendrave të paraburgimit para burgjeve sipas një Master Planit për Infrastrukturën Gjyqësore, po avancon me ngadalësi. Zbatimi i Master Planit për sistemin e paraburgimit para gjyqit është mbrapa me afatin. 80 të burgosur të ndërtuar mbahen akoma nga policia në qendra paraburgimi. Një rregullore për paraburgimin para gjyqit është një hap përpara, por nuk përmbush praktikën ndërkombëtare, e cila kërkon që rregullorja e paraburgimit para gjyqit duhet të kthehet në ligj.

Masat themelore kundër keqtrajtimin gjatë paraburgimit para gjyqit si për shembull aksesit për një avokat dhe doktor dhe njoftimi i të afërmeve për parandalimin e personit, jo gjithmonë zbatohen rregullisht. Kodi i etikës për sistemin e burgjeve nuk po respektohet akoma në mënyrë të rreptë dhe masat për garantimin sigurinë e të burgosurve, mbeten ende të dobëta. Komisioni Mbikëqyrës për Ekzekutimin e Dënimeve të Burgosjes nuk është akoma operativ. Ky organ këshillon Ministrin e Drejtësisë për çështjet e rendit dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe të ndaluarve.

Liria e besimit fetar garantohet me ligj dhe në praktikë. Sipas Kushtetutës, nuk ka një fe zyrtare dhe të gjitha fetë janë të barabarta. Pavarësisht disa incidenteve të izoluara, Shqipëria vazhdon të jetë një shembull i çmuar i harmonisë fetare në rajon. Megjithatë, pakënaqësia e komuniteteve fetare po nxitet nga dështimi i autoriteteve për kthimin e plotë të pronarë dhe objekteve të tjera.

Liria e shprehjesgarantohet me kushtetutë në Shqipëri. Legjislacioni që mund të ishte një shtyllë e fortë për lirinë e medias, mbetet ende varur në parlament. Statusi i gazetarëve në kodin e punës është përmirësuar. Ndryshimet në përbërjen e Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit dhe të Këshillit të Bordit Drejtues të Radio-Televizionit Kombëtar për të përfshirë në to specialistë nga OJQ-të, pritet ta bëjnë mbikëqyrjen e medias më përfaqësuese dhe efikase, dhe transmetuesin publik më neutral, nëse vihet në zbatim në përputhje me standardet europiane (*shikoni gjithashtu edhe Politikën Audio-vizuale*). Megjithatë, marrëveshje politike e gushtit (*shikoni Parlamenti*) duhet të zbatohet me kujdes në mënyrë që të shmanget kufizimi i efekteve pozitive të kësaj reforme.

Një amendim ligjor u ndalon pronarëve të medias elektronike që të marrin pjesë në tenderat e sektorit publik. Kjo mund të mbartë probleme nga pikëpamja e *acquis*-it nga perspektiva e konkurrencës së biznesit. Ai duhet plotësuar me një përjasje më gjithëpërfshirëse për pronësinë mediatike. Sidoqoftë, është një masë e fortë anti-korrupsion dhe duhet të kontribuojë në lirinë e medias. Një Këshill i ri për Etikën e Medias ka potencialet për promovimin e vetë-rregullimit të medias dhe përmirësimin e standardeve të gazetarisë.

Megjithatë, progresi i përgjithshëm në këtë fushë, që është një përparësi kyçe afatshkurtër e Partneriteti European, ka qenë i kufizuar. Shumë burime mediesh mbeten subjekte të interesave politike apo ekonomike. Kuadri ligjor për lirinë e medias, mbetet i pamjaftueshëm. Zbatimi i mangët i legjislacionit ekzistues është gjithashtu një mangësi e madhe. Standardet profesionale dhe etike të medias shqiptare, mbeten të ulëta. Masat për këto standarde janë nën diskutim me partnerët e komunitetit ndërkombëtar, por nuk janë vënë ende në zbatim.

Gazetarët vazhdojnë të jenë subjekt kërcënimesh për ndjekje penale për shpifje (defamacion) që parashikon ndëshkime të rënda. Shpifja vazhdon të ndëshkohet me burgim deri në tre vjet. Megjithëse nuk aplikohen më dënime me burg, dhe planifikohet një amendim i Kodit Penal për të shfuqizuar ndëshkimet kustodiale, Shqipëria ende s'ka miratuar legjislacionin e duhur mbi shpifjen dhe duhet të amendojë kodin e vet penal në mënyrë që të heqë burgosjen si opsion për ndëshkimin e shpifjes.

Kushtetuta garanton **lirinë e mitingjeve dhe tubimit**, e Qeveria përgjithësisht i respekton këto të drejta.

Ligji liberal për OJQ-të çoi në shumimin e **organizatave të shoqërisë civile** të cilat operojnë pa kufizime qeveritare. Ka pasur disa fushata të suksesshme nga aktorë të shoqërisë civile kundër apatisë politike.

Megjithatë, aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri vuajtën nga mungesa e theksuar e burimeve të qëndrueshme, mungesa e kapaciteteve organizative dhe aftësive (veçanërisht aftësitë e përkrahjes) si dhe mungesa e traditës në përfshirjen e bërjes së politikave. Për këto arsye, dialogu i OJQ-ve me qeverinë shqiptare, mbetet i dobët. Shqipëria duhet të përfitojë nga një politikë qeveritare që në mënyrë aktive inkurajon përfshirjen e OJQ-ve në procesin kryesor të vendim-marrjes. Aktorët e shoqërisë civile mund të përfitojnë gjithashtu nga vendosja e lidhjeve më të ngushta me organizata homologe rajonale.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Në lidhje me të drejtat e femrave, ekzistojnë dispozita ligjore për të drejtat e barabarta në një numër fushash të jetës si sigurimet sociale dhe arsimit. Kodi i Punës i 1995-ës (neni 9) përcakton garanci për mos-diskriminimin në të dy sferat publike dhe private. Kodi i Punës dhe Akti i Barazisë Gjinore i 2004-ës i referohen parimit të trajtimit të barabartë të femrave dhe burrave, me qëllimin që punëdhënësit duhet të japin rrogën e njëjtë për punën me vlera të njëjta dhe janë të aplikueshme si për sektorin publik, edhe atë privat. Legjislacioni i punës akordon masa speciale mbrojtëse për punonjësit shtatzëna dhe me fëmijë në periudhën e ushqimit me gji që janë një shkallë më lart sesa masat e përgjithshme mbrojtëse për të gjithë punëtorët. Mbështetja financiare qeveritare promovon punësimin e femrave, veçanërisht për të ndihmuar femrat pa përkrahje që të gjejnë një punësim afatgjatë. Këtu përfshihen viktimat e trafikimit, femrat rome dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuara dhe femrat me probleme sociale.

Megjithatë, femrat vazhdojnë të jenë subjekt i formave të shumta të diskriminimit në jetën ekonomike dhe sociale dhe vazhdojnë të jenë pak të përfaqësuara në proceset vendim-marrëse politike dhe ekonomike. Pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është e ulët dhe e kufizuar në vetëm disa sektorë. Pavarësisht se

Akti i Barazisë Gjimore në mënyrë specifike synon të eliminojë diskriminimin e djepërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, nuk i përkufizon këto koncepte. Mekanizmat për të vënë në zbatim parimet e trajtimit të barabartë të femrave dhe burrave, si Komiteti Shtetëror për Mundësi të Barabarta, janë relativisht të dobëta. Martesa e detyruar dhe dhuna në familje kundër grave nuk adresohen në mënyrë specifike nga strategjitë qeveritare ose legjislativi dhe vazhdojnë të jenë probleme serioze. Të paktën 1/3 e femrave në Shqipëri llogaritet se kanë pësuar dhunë fizike brenda familjeve të tyre.

Të drejtat e fëmijëve përgjithësisht mbrohen nga legjislativi aktual. Një Plan Kombëtar i Aksionit për Fëmijët është ngritur dhe një pikë fokale për fëmijët është përcaktuar tashmë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta. Megjithatë, në praktikë mbrojtja është e kufizuar.

Janë raportuar disa çështje të trafikimit të fëmijëve dhe abuzimit të tyre, përfshi abuzimin seksual. Fëmijët e mbajtur në shtëpi privohen nga e drejta e tyre për arsimim. Neni 7 i Kartës Sociale Europiane për të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje s'është përmbushur, sepse masat e autoriteteve për mbrojtjen e të miturve nga shfrytëzimi seksual patën deri tani efekte të kufizuara. Gjendja mund të përmirësohet me ngritjen e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve dhe forcimin e luftës kundër varfërisë.

Shqipëria arriti regjistrimin e plotë në **arsimin** fillestar në fillimin e tranzicionit, por së fundmi ka përqindjet më të ulëta të regjistrimit në shkollimin dytësor dhe tretësor në rajon. Në tre vitet e fundit, përmirësime modeste në përqindjet e regjistrimeve janë bërë në të gjitha nivelet e arsimit. Shumë shkolla private janë hapur, shumica në qytetet e mëdha. Qeveria ka shpallur reforma të mëdha për përmirësimin e niveleve të ulëta të shkollimit në Shqipëri. Masa të kufizuara janë marrë për rritjen e rrogave në sistemin e arsimit publik. Qeveria ka shpallur plane për të rritur konsiderueshëm buxhetin për arsimin.

Megjithatë, mesatarisht fëmijët ndjelin shkollën vetëm për 9.6 vjet: kjo është të paktën 5 vite nën mesataren e OECD-së. Ende nuk janë vendosur masa për kontrollimin e cilësisë në arsimin privat në nivelet fillestare, dytësore dhe tretësore. (*shikoni gjithashtu edhe Arsimin nën Politikën Sociale*).

Për sa i takon **personave vulnerabël nga ana sociale**, gjakmarrja dhe krimet e kësaj natyre vazhdojnë, veçanërisht në veri të vendit. Motivet kryesore të konflikteve mbeten grindjet për çështje pronësie dhe trafikimi i personave. Zbatimi i një ligji që siguron ngritjen e një këshilli koordinues kombëtar për zhvillimin e një strategjie kombëtare kundër këtij problemi dhe për të koordinuar punën e agjencive qeveritare që merren me këto çështje, nuk ka filluar akoma. Në lidhje me **personat me aftësi të kufizuara**, janë ndërmarrë hapa fillestarë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Një grup kontakti është ngritur për të koordinuar ministrinë e përfshira. Një vendim gjithashtu është marrë për të rritur asistencën shtetërore për njerëzit me aftësi të kufizuara. Megjithatë, nevojitet ende shumë punë. Ngritja e një qendre për komunitetin në Tiranë ka mundur që pranimi në institucionet e shëndetit mendor të ulet me 40%. Kjo ka për qëllim përsëritjen e këtij modeli.

Në fushën e **të drejtave të punës dhe të sindikatave**, punëtorët kanë të drejtë të formojnë sindikata të pavarura. Kodi i Punës rregullon ngritjen e sindikatave të tilla dhe ekziston një kuadër ligjor për ndërmjetësimin, pajtimin dhe arbitrimin. Pozitat e sindikatave minohen nga dobësia e sektorit industrial, dominimi i sipërmarrjeve shumë të vogla, papunësia e lartë, emigrimi i konsiderueshëm dhe një ekonomi shumë informate. Pavarësisht faktit se punësimi është kryesisht në sektorin privat, shteti ende luan një rol dominues në organizimin e ekonomisë dhe dialogut social. Organi kryesor për dialogun social është Këshilli Kombëtar i Punës. Mohimi i të drejtës për grevë për nëpunësit civilë dhe disa kategori të tjera punonjësisht, nuk është në linjë me nenin 6 të Kartës Sociale Europiane, që ka të bëjë me të drejtën për marrëveshje kolektive.

Për sa i takon të drejtave së pronësisë, Komisioni Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave është transformuar në Agjencisë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke u bërë pjesë e ekzekutivit, ndërkohë që më parë i jepte llogari drejtpërdrejt parlamentit. Kjo masë ka potencialet që të bëjë me efikas administrimin e të drejtave të pronësisë. Ligji i ri u ofron banorëve të vendbanimeve të ndërtuara pa leje në tokë shtetërore, mundësinë që t'i legalizojnë kundrejt një pagese apo tarife, madje edhe kur ngrihen pretendime të tjera për tokën. Një pjesë e tarifës do të kontribuojë në fondin kompensues për ish-pronarët. Ky mekanizëm ka nevojë të testohet, por mund të kontribuojë në vendosjen e të drejtave të qartë të pronësisë dhe të përfshijë më shumë njerëz në ekonominë formale.

Megjithatë, regjistrimi dhe rikthimi i pronave të konfiskuara gjatë epokës komuniste, mbeten që shqetësim serioz. Regjistrimi i pronave të çmuara bregdetare dhe urbane ka mbetur veçanërisht i ngadaltë. Afati për dorëzimin e pretendimeve të pronës është shtyrë deri në fund të vitit 2008. Kjo çështje është një përparësi kyçe e Partneritetit Europian, pasi pasqyron faktin se siguria ligjore e pronësisë mbi pronën është jetike për përmbushjen e angazhimeve të MSA-së dhe është një parakusht për investimet vendëse dhe të huaja që nevojiten për zhvillimin ekonomik.

Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Në fushën e të drejtave kulturore, legjislacioni shqiptar njeh tre minoriteteve kombëtare (grekë, maqedonas etnikë dhe malazezë) dhe dy minoriteteve etno-gjuhësorë (vllahë dhe romë). Minoriteti grek është grupi më i madh, i udhëhequr nga shoqata kulturore Omonia. Mbizotëron një frymë tolerance në lidhje me minoritetet. Mbrojtja e minoriteteve është vendosur së fundmi nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Shqipëria ka bërë përpjekje për të krijuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e minoriteteve, dhe ka siguruar shkolla dhe kurse për minoritete të caktuara në zona specifike. Shqipëria së fundmi nënshkroi Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore.

Megjithatë, zbatimi i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare mbetet i paplotë. Arsimi në gjuhën minoritare ende nuk është i disponueshëm në të gjitha zonat ku ka kërkesa. Pak progres ka pasur në përdorimin administrativ të gjuhëve minoritare, përdorimit të emrave tradicionalë dhe në sigurimin e aksesit në media për minoritetet. Mungesa e të dhënave të besueshme statistikore për përqindjet e minoriteteve, pengon zhvillimin e politikave për mbrojtjen e tyre. Puna e Komitetit të Veçantë Shtetëror për Minoritetet vazhdon të vështirësohet nga mungesa e rregullave të qartë në lidhje me përbërjen dhe mandatin e tij. Shqipëria nuk ka nënshkruar Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare.

Llogaritet se janë 95 000 romë në Shqipëri. Po zbatohet një Strategji Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Minoritetit Rom është hartuar. Nismat për integrimin në punë, arsimin dhe regjistrimin e fëmijëve janë përqendruar në grupet romë në kuadrin e kësaj strategjie. Janë mbajtur aktivitete informuese rajonale dhe tryeza të rrumbullakëta.

Megjithatë, pabarazia midis situatës sociale dhe ekonomike të romëve dhe pjesës tjetër të popullatës, po rritet. 78% e popullsisë romë jeton në varfëri dhe 39% në varfëri të skajshme. Vetëm 12% e romëve janë regjistruar në arsimin dytësor, krahasuar me përqindjen 81% në shkallë vendi. Situata e komunitetit rom në Tiranë është përkeqësuar ndjeshëm në muajt e fundit. Aktualisht janë rreth 40 000 romë në Tiranë që kanë nevojë për mbështetje sociale dhe ekonomike.

Strategjia e qeverisë për romët vuan nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e saj. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MoLSA), ka caktuar tre nëpunës civilë që të

monitorojnë zbatimin e saj. Pesë ministri të tjera janë përfshirë në zbatimin e pjesë të Strategjisë (Ministria e Shëndetësisë, Kulturës, Arsimit, Transportit dhe e Brendshme).

Informimi publik për ekzistencën dhe përmbajtjen e Strategjisë, mbetet i mangët në dymbëdhjetë rajone të Shqipërisë. Komuniteti rom vuan nga mungesa e njohurive të autoriteteve vendore në rajone për situatën e tyre dhe mungesa e organizatave të shoqërisë civile që të përfaqësojnë interesat e tyre. Faktorët sociale dhe lëvizja e grupeve të caktuara e bëjnë mungesën e aksesit në arsimim dhe shërbim shëndetësor, sidomos vaksinimit, një problem të veçantë. Regjistrimi i dobët ose mosregjistrimi i lindjeve të fëmijëve romë, si edhe mungesa e dokumenteve personale, i bën ata mjaft vulnerabël ndaj trafikimit njerëzor.

Numri i **refugjatëve dhe personave të shpërngulur** në Shqipëri vazhdon të jetë i vogël dhe rrjedhimisht nuk përbën problem serioz.

2.3. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Në qershor 2003, Shqipëria ratifikoi një marrëveshje imuniteti dypalëshe me Shtetet e Bashkuara që bie ndesh me “parimin themelor të BE për marrëveshjet midis një shteti palë në Statutin e Romës të **Gjykatës Ndërkombëtare Penale** dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me kushtet e dorëzimit të personave në gjykatë” i miratuar nga Këshilli i BE-së në shtator 2002. Tashmë zhvillime të reja kanë ndodhur në këtë aspekt.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Europian.

Shqipëria ka vazhduar të luajë rol aktiv dhe konstruktiv në rajon. Është anëtare aktive e nismave shumëpalëshe rajonale në Europën Juglindore, përfshi Paktin e Stabilitetit, Procesin e Bashkëpunimit në Europën Juglindore, Nismës së Europës Qendrore, Nisma Adriatik-Jon, Nisma e Sigurisë Kufitare dhe Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi. Shqipëria është angazhuar në ngritjen e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Në 2006, Shqipëria kishte presidencën dhe priti samitet e Nismës së Europës Qendrore dhe Nismës Adriatik-Jon. Shqipëria është palë në Traktatin e Komunitetit Energjetik që hyri në fuqi në korrik 2006. Shqipëria gjithashtu nënshkroi marrëveshjen për Zonën e Përbashkët të Aviacionit Europian në qershor 2006.

Shqipëria po merr pjesë aktivisht në negociatat për miratimin e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë rajonale brenda kuadrit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë në Europën Qendrore (CEFTA) e zgjeruar dhe amenduar, që u kançuan në prill 2006. Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lire me të gjitha shtetet e Europës Juglindore. Gjithashtu ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Kosovën.

Shqipëria ka zhvilluar më tej **marrëdhëniet me fqinjët dhe shtetet e tjera** në rajon:

Marrëdhëniet me *Republikën ish-jugosllave të Maqedonisë* vazhduan të konsiderohen përparësi. Vizitat e ndërsjella e nivelit të lartë janë shoqëruar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushat e bashkëpunimit policor, transportit, energjisë, mbrojtjes, turizmit, kulturës, informacionit, dhe hapjen e një pikë-kalimi kufitar shtesë.

Marrëdhëniet me Malin e Zi vazhduan të jenë shumë të mira. Shqipëria që ndër të parat shtete që njohën pavarësinë e Malit të Zi pas referendumit në maj 2006 dhe planifikon të hapë një ambasadë në Podgoricë.

Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për transportin hekurudhor dhe në liqen, si dhe një Memorandum Mirëkuptimi për Zhvillimin Ndërkufitar në Liqenin e Shkodrës.

Marrëdhëniet me *Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë*, kanë qenë pozitive dhe stabël, megjithatë mbeten ende për t'u vjelur potencialet maksimale për sa i përket tregtisë dhe bashkëpunimit,

Shqipëria mbajti një politikë konstruktive kundrejt Kosovës. Vizitat e ndërsjella të nivelit të lartë sinjalizuan angazhimin më aktiv të Shqipërisë në këtë çështje. Në takimin e marsit 2006 me Troikën e BE, Shqipëria e bëri të qartë qëndrimin për të ardhmen e Kosovës, që është në linjë me atë të komunitetit evropian.

Italia vazhdon të jetë partneri kryesor tregtar, me 40% të tregtisë së Shqipërisë, si edhe donatori më i madh dypalësh. Italia ka investuar në shkallë të konsiderueshme në fusha si infrastruktura, transporti, shëndetësia dhe energjia. Megjithatë, problemet ligjore dhe administrative kanë penguar projektet e investimeve të mëdha të promovuara nga kompanitë italiane në sektorin e infrastrukturës.

Greqia vazhdon të jetë partneri i dytë më i madh tregtar, si dhe një donatore e konsiderueshme dypalëshe dhe investuese. Marrëdhëniet me Greqinë konsiderohen nga Qeveria shqiptare të rëndësishme nga ana strategjike. Një marrëveshje 5-vjeçare për bashkëpunim dhe zhvillim u zgjat deri në 2011.

3. KRITERET EKONOMIKE

3.1. Hyrje

Në ekzaminimin e zhvillimeve ekonomike të Shqipërisë, përjasja e Komisionit udhëhiqet nga përfundimet e Këshillit Evropian në Kopenhagen në qershor 1993, të cilat pohojnë se anëtarësimi në Bashkim Evropian kërkon ekzistencën e një ekonomike tregu funksionale, si edhe kapacitetet për të përballuar trysninë konkurruese të forcave të tregut brenda Bashkimit.

3.2. Vlerësimi sipas kritereve të Kopenhagenit

3.2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionuese

Pikat thelbësore të politikës ekonomike

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare financiare vazhdoi që të jetë një shtyllë e rëndësishme për politika ekonomike. Programi i mëparshëm i Fondit Monetar Ndërkombëtar u përfundua me sukses në nëntor 2005 dhe një program i ri trevjeçar filloi në shkurt 2006. Politika e kujdesshme monetare vazhdoi të jetë e padiskutueshme dhe kontribuoi në mbajtjen e inflacionit nën kontroll. Më pas u ndoqën parimet bazë të politikave fiskale që synojnë konsolidimin fiskal. Është ruajtur konsensusi i gjerë për parimet themelore dhe drejtimitet e politikës ekonomike.

Stabiliteti makro-ekonomik

Klima makro-ekonomike shqiptare vazhdoi të jetë e karakterizuar nga një rritje e fuqishme e PBB-së dhe mbajtjes në kuota të ulëta të inflacionit. Megjithatë, vendi vuajti nga prerjet e shpeshta të energjisë për thujtje katër muaj në fund të 2005-ës. Kjo erdhi kryesisht si rezultat i varësisë së madhe nga burimet hidrike për prodhimin e energjisë elektrike si dhe nga dështimi i tenderave për blerjen e energjisë shtesë

nga jashtë. Kjo krizë pati implikime në rritjen ekonomike të llogaritura në 4.5% të PBB-së në 2005, kur shoqërohet edhe me dobësimin e aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimeve dhe rënien e rritjes eksportuese. Vlerësimi i rritjes PBB pësoi rënie në 5.5% në 2005. Në përgjithësi, Shqipëria ka mbajtur një klimë stabël makro-ekonomike.

Përqindja e njerëzve që jetojnë në varfëri, u ul nga 25% në 2002 në rreth 18% në 2005. Kjo shifër do të thotë se 220 000 njerëz iu shamngën varfërisë gjatë këtyre viteve. Kjo kryesisht nga rritja e qëndrueshme e të ardhurave të shpenzueshme (disposable income). Vazhdoi progresi i mirë në uljen e varfërisë.

Deficiti tregtar u thellua në 24.1% të PBB-së në 2005, krahasuar me 21.7% të PBB-së një vit më parë. Për shkak të vlerësimit të lekut shqiptar dhe konkurrencës më të fortë në industrinë tekstile, rritja në eksportimin e mallrave ra në 9% në 2005 nga 23% në 2004. Për të njëjtën periudhë, importi i mallrave u rrit në 15%, kryesisht në kurriz të rritjes së qëndrueshme dhe importit të energjisë elektrike në fund të vitit. Gjatë gjysmës së parë të 2006-ës, deficiti tregtar u thellua edhe me 19% në bazë vjetore. Ky përkeqësim i vazhdueshëm ndoshta pasqyron përmirësimet në administratën doganore, pasi më tepër mallra kanë kaluar përmes kanaleve formale. Baza eksportuese në Shqipëri ka mbetur shumë e ulët, e ngushtë dhe pa diversitet, kryesisht për shkak të mungesës së konkurrueshmërisë që s'ka lidhje me çmimin (non-price), çka rezultoi përveç të tjerash nga infrastruktura e dobët dhe mjedisi jo-ftues i biznesit. Për shkak të përkeqësimit të bilancit tregtar, deficiti aktual i llogarive (duke përfshirë transfertat zyrtare) regjistroi rritje në 7.8% të PBB-së, krahasuar me 5.5% në 2004. Në përgjithësi, deficitet e jashtme u thelluan ndjeshëm.

Transfertat nga jashtë dhe remitancat e tjera janë llogaritur në rreth 14.6% të PBB-së në 2005, 19% më shumë se në 2004. Transfertat private janë bërë kështu një burim të ardhurash i rëndësishëm dhe relativisht stabël. Sipas burimeve vendëse, ato janë arritur 33% të të ardhurave të shpenzueshme të një familje mesatare dhe thuajse 40% në zonat rurale. Rezervat bruto vazhduan të rriten përgjatë 2005-ës. Kjo falë kryesisht hyrjes të transfertave private dhe investimeve të drejtpërdrejta të huaja (FDI), por edhe nga ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e valutës së huaj në gjysmën e parë të vitit. Rezervat në valutë të huaj arritën 1.2 miliard EUR në fund të 2005, një rritje 17% krahasuar me fundin e vitit 2004. Kjo është ekuivalente me 4 muaj importe. Borxhi i jashtë ra në 17.6% të PBB-së në 2005, nga 18.0% në 2004. Në përgjithësi, remitancat e konsiderueshme dhe transferuat e tjera nga jashtë, vazhduan të mbulojnë një pjesë të madhe të deficitit tregtar.

Përqindja e papunësisë (sipas të dhënave zyrtare) pësoi rënie të vogël në 14.2% në 2005 nga 14.4% në fund të 2004-ës. Të dhënat për tremujorin e parë të 2006-ës, tregojnë një rënie të mëtejshme të papunësisë në 14%. Sidoqoftë, përqindja e saktë e papunësisë është e vështirë të llogaritet për shkak të punësimit të konsiderueshëm informal, veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe ndërtimeve. Mund të thuhet si përfundim se situata në tregun e punës është përmirësuar lehtësisht.

Në korrik 2005, Banka e Shqipërisë (BoA) ndryshoi drejtimin e instrumenteve të saj operuese duke filluar të kryejë marrëveshje të riblerjes reverse (reverse purchase), duke injektuar likuiditete shtesë në sistemin bankar. Drejtimi i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë ndryshoi sërish në tremujorin e parë të 2006-ës, pasi i tërhoqi likuiditetet e tepërta nga bankat tregtare. Përqindja kyçe e interesit kishte mbetur e pandryshuar deri në mesin e korrikut 2006, kur Banka e Shqipërisë e ngriti në 5.25%, në kurriz të rritjes së trysnive të inflacionit dhe në mënyrë që të përmbante zgjerimin e fuqishëm të rritjes së kreditimit. Banka e Shqipërisë ekzaminoi kushtet paraprake për një ndryshim gradual në strategjinë e saj monetare drejt një regjimi me target eksplicit inflacionin me qëllim rritjen e transparencës dhe besueshmërinë e politikave të veta monetare. Në përgjithësi, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, ishte e besueshme.

Rritja e fuqishme në ofertën e parave, që arriti kulmin në mesin e vitit 2005, është ngadalësuar. Pakësimi i huave publike u shkaktua pjesërisht nga bumi masiv në kreditin e induktuar nga kërkesa e lartë për asete monetare. Rritja vjetore e agregatit monetar M3³ ra nga 19% në mesin e 2005-ës në 14% në tremujorin e fundit të 2005-ës dhe më tepër në 11% në maj 2006. Trysnia e vlerësimit të lekut shqiptar kundrejt euros u lehtësua drejt fundit të 2005-ës. Leku fitoi ndaj euros me rreth 3% në terma nominalë gjatë 2005-ës, dhe qëndroi relativisht stabilë përballë euros gjatë tetë muajve të parë të 2006-ës. Në përgjithësi, rritja e ofertës për para u zbut.

Inflacioni mesatar vjetor qëndronte në 2.5% në gusht 2006. Inflacioni ndoqi një kurbë në rritje që nga korriku 2005, kur inflacioni CPI një rënie prej 1.8% (vit për vit). Kulmin e arriti në tetor 2005 (3.3% vit për vit) për shkak të trysnisë konstante nga rritja e çmimeve të naftës mbi disa çmime vendëse. Inflacioni mesatar arriti në 2.4% në 2005, duke qëndruar në nivelin më të ulët të objektivit informal 2-4% të Bankës së Shqipërisë. Pas një rënieje të përkohshme në tremujorin e parë të 2006-ës, trysnitë modeste të inflacionit u shfaqën sërish në tremujorin e dytë të 2006-ës. Kjo u nxit nga zhvillime të jashtme, likuiditetet e tepërta që vazhdonin në sektorin bankar dhe oferta në ulje e produkteve bujqësore. Si rezultat, fuqizimi i lekut shqiptar kundrejt euros u pakësua. Në përgjithësi, inflacionit ka mbetur në kuota të zbutura.

Në tetor 2005, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe autoritetet ranë dakord për pjesën e mbetur të buxhetit 2005 dhe parametrat kyç të buxhetit 2006. Këto parashikuan një sërë reformash për administratën tatimore dhe menaxhimin e financave publike. Këto masa patën për qëllim përmirësimin e disiplinës fiskale, eficientësinë së administratës tatimore, mbledhjes së taksave si dhe shpenzimeve publike dhe menaxhimit të borxhit. Përgatitjet për një analizë të plotë dhe reformim të sistemit të pensioneve gjithashtu janë vënë në lëvizje. Ekzekutimi i buxhetit 2005 ishte më i favorshëm nga sa pritej, kryesisht falë performancës më të mirë të të ardhurave dhe rritjes së lehtë në shpenzime. Në fund të 2005-ës, deficitin e përgjithshëm qeveritar kishte arritur në 3.6% të PBB-së kundrejt 5.1% në 2004. Falë performancës së favorshme të buxhetit në gjysmën e parë të 2006-ës, një buxhet shtesë u miratua për gjysmën e dytë të vitit e pasqyruar nga mbledhja më e madhe e tatimeve dhe taksave doganore. Buxheti parashikoi një shtesë të shpenzimeve me 2.2% të PBB-së kryesisht për zhvillimin e infrastrukturës. Borxhi publik total ra në 55.3% të PBB-së në 2005 krahasuar me 56.5% në 2004. Megjithatë, progres shumë i pakët është bërë në forcimin e menaxhimit të borxhit publik. Ministrisë së Financave akoma i mungon një strategji gjithëpërfshirëse për menaxhimin e borxhit dhe kapacitetet e nevojshme për menaxhemin e riskut. Këto mund të mundësonin zgjatjen e maturimit të borxhit të brendshëm dhe futjen e instrumenteve të reja të borxhit. Konsolidimi fiskal në përgjithësi ka vazhduar, por një qëndrim më rigoroz për uljen e mëtejshme të borxhit, mbetet vendimtar.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë mjaft neutrale gjatë shumicës së eriudhës raportuese me një rregullim të lehtë rritës të politikës kryesore të përqindjes në korrik 2006. Rregullime të mëtejshme fiskale u ndoqën. Në përgjithësi, miksi i politikave makro-ekonomike qëndroi gjerësisht i mjaftueshëm.

Bashkëveprimi i lirë i forcave të tregut

Spektori privat përfaqësonte afërsisht 80% të PBB-së në 2005, dmth. 5% të PBB-së më e lartë se 2004. Në tremujorin e parë 2006, punësimi në sektorin privat zinte mbi 80% të tërë të punësuarve, nga të cilët 72% punonin në sektorin e bujqësisë. Numri i sipërmarrjeve të reja të regjistruara u rrit me 10 000 në 2005,

³ M3 (broad money): masë e parashë në qarkullim ku përfshihen depozitat në valutë të huaj + paratë jashtë sistemit bankar.

një rritje 4% krahasuar me 2004. Edhe 7 500 biznese të reja u ngritën dhe u regjistruan gjatë pesë muajve të parë të 2006-ës, duke konfirmuar prirjen e favorshme drejt një ekonomie më pa informale. Në tregi kanë qenë aktive kryesisht bizneset private (49%), shërbimet (24%), industria (11%) dhe transporti (10%). Në përgjithësi, sektori privat është zgjeruar më tej.

Vonesat në privatizimet e mëdha kanë vazhduar, veçanërisht në sektorët e telekomunikacioneve dhe energjisë. Ratifikimi i marrëveshjes së shitjes që do të përfundonte privatizimin e Albtelecom-it është refuzuar nga parlamenti shqiptar në tetor 2005. Kjo çoi në një rishqyrtim të kontaktës së shitjes dhe procedurës së tenderit. Privatizimi i Naftës Shqiptare të Rafinuar dhe Tregtuar (???) dështoi në mungesë të ofertave të kënaqshme. Është përgatitur privatizimi i kompanisë shtetërore të sigurimeve, INSIG. Privatizimet e mëdha kanë vazhduar të vuajnë vonesa të mëtejshme në përgjithësi.

Hyrja dhe dalja në tregun e lirë

Barrierat administrative në hyrjen në treg janë reduktuar në 2006. Koha mesatare për regjistrimin e biznesit u ul ndjeshëm nga 30 në 8 ditë. Formalitete të tjera administrative janë thjeshtuar dhe Regjistri Tregtar është decentralizuar. Këto masa u futën në bazën e Planit të ri të Veprimit për Heqjen e Barrierave Administrative, miratuar nga Këshilli i Ministrave në mars 2006. Megjithatë, përpara janë ende disa sfida të mëdha, sidomos kostoja relativisht e lartë për hapjen dhe mbylljen e një biznesi, dokumentacioni i kufizuar kadastral dhe përqindja dhe objekti i ekonomisë informate⁴. Klima e biznesit ka vazhduar të vuajë nga një mjedis i dobët ligjor si për shembull mungesa e përkufizimit të qartë të të drejtave të pronësisë, nga infrastruktura e dobët, furnizimi i mangët me energji elektrike dhe korrupsioni i gjerë. Qeveria duket e angazhuar për adresimin e këtij të fundit. Në përgjithësi, njëfarë progresi është arritur në përmirësimin e mjedisit të biznesit, megjithatë, pavarësisht veprimeve të vendosura të qeverisë, shumë mbetet për t'u bërë në luftën kundër korrupsionit.

Sistem ligjor i mjaftueshëm

Vonesat në gjykata kanë vazhduar të kenë efekte negative mbi klimën e biznesit. Kjo për shkak të vështirësisë për marrjen e vendimeve të gjykatës dhe ekzekutimit të kontratave në çështje si ato tregtare dhe likuidimi i ndërmarrjeve. Të drejtat e pronësisë mbi tokën nuk janë garantuar ende, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare. Rrjedhimisht, pasiguria ligjore në rikuperimin e kolateralit akoma bëhet pengesë për kreditë bankare, investimet dhe zhvillimin e ekonomik. Zbatimi i të drejtave të pronësisë ka vazhduar të jetë i dobët dhe progresi i pakët është arritur në përmirësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor.

Sektori financiar me zhvillim të mjaftueshëm

Kreditimi total arriti në 14.6% i PBB-së në fund të 2005-ës, krahasuar me 9% të PBB-ë në fund të 2004-ës. Raporti kreditim/depozitë u rrit edhe më tepër, nga 19% në 2004 në thujse 29%. Kreditimi dhënë sektorit privat gjithashtu shënoi një zgjerim të shpejtë, duke u rritur me 74% në 2005. Kjo ishte një rritje dy herë më e shpejtë se në 2004. Rritja e shpejtë në kreditim vazhdoi në gjysmën e parë të 2006-ës, duke arritur 65% në vit për vit. Huat e denominuara në valutë të huaj përbënë rreth 75% të stokut total huadhënës. Kjo vazhdoi të rrisë risqet potencialë të valutës së huaj, duke kërkuar menaxhim të kujdesshëm risku nga bankat shqiptare. Përgatitjet për vendosjen e një zyre informuese mbi kreditimin kanë avancuar, me

⁴ INSTAT e vlerësoi përqindjen e vlerës së shtuar të prodhuar nga ekonomia e pavëzhguar në 30.6% (mesatarja për vitet 2001-2003).

synim rritjen e kreditimit të disponueshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nëpërmjet rritjes së efikasitetit të menaxhimit të riskut kreditues. Në përgjithësi, niveli i ndërmjetësimit financiar është rritur nga relativisht nivele të ulëta.

Spektori bankar përbëhet nga 17 banka, nga të cilat tri zotërohen plotësisht nga investues vendës dhe 14 nga të huajt ose "jonit-venture". Të gjitha bankat janë nën pronësinë private, përveç 40% të aksioneve të shtetit në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë. Përqendrimi i sektorit ka vazhduar relativisht i lartë, me tri bankat më të mëdha në Shqipëri që dominojnë tregun me thuhajse 3/4 e depozitave totale dhe thuhajse 2/3 të aseteve totale në fund të 2005-ës. Përqindja e interesit huadhënie-depozitë qëndronte në 8% në mesin e 2006-ës për huat e denominuara në lek dhe depozitat. Fitimi mesatar në asete u rrit në 1.4% në 2005 dhe fitimi mesatar në aksione (equity) në 22.2%. Përqindja e huave jo-performuese në kreditin total qëndroi i moderuar në 2.3% në fund të 2005-ës dhe u rrit në 3.0% në mars 2006. Raporti i kapitalit të mjaftueshëm u ul me 3% në 18.6 në 2005, që sidoqoftë është mjaft mbi nivelin minimal 12% të vendosur nga BoA. Sistemi bankar vazhdoi të jetë i shëndoshë, elastik dhe fitimprurës, me relativisht shkallë të lartë përqendrimi.

Ligji i ri për sektorin bankar u miratua nga Këshilli i Ministrave në korrik 2006 dhe pritej të hynte në fuqi përpara fundit të vitit. Ky ligj sjell kuadrin legjislativ bankar gjerësisht në linjë me standardet ndërkombëtare. Kuadri rregullues, qeverisës dhe mbikëqyrës për sektorin financiar jo-bankar mbeti i dobët, duke i munguar kapacitetet e mjaftueshme, transparenca dhe pavarësia. Sidoqoftë njëfarë progresi është shënuar në përgatitjen përngritjen e një Autoriteti të ri të Mbikëqyrjes Financiare. Ky autoritetet pritet të mbikëqyrë tregun e sigurimeve, pensioneve dhe kapitalit. Rregullimi financiar dhe mbikëqyrja përgjithësisht janë përmirësuar.

3.2.2 *Kapaciteti për të përballuar trysninë e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së*

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Rritja ekonomike ka qenë e fortë dhe arriti një shkallë të kënaqshme qëndrueshmërie, pavarësisht krizës energjetike në fund të 2005-ës. Treguesit fiskalë kanë vazhduar të përmirësohen, politika monetare ka qenë e kujdesshme dhe arriti të mbante të ulët inflacionin. Megjithatë, përkeqësimi në tregti dhe deficitet e llogarive rrjedhëse ka rritur dobësinë afatshkurtër dhe afatmesme të pozitave të jashtme të vendit. Bumi i kreditimit vazhdon të jetë një sfidë në kontekstin e imbalancave të llogarive të jashtme. Në përgjithësi, Shqipëria e ka arritur në stabilitetin makro-ekonomik në shkallë mjaft të gjerë. Kjo ka kontribuar në progresin e saj drejt të qenit një ekonomi tregu funksionale.

Kapitali i mjaftueshëm njerëzor dhe fizik

Arsimi fillestar është vendosur thuhajse plotësisht. Megjithatë, regjistrimit në arsimin dytësor dhe tretësor qëndronin respektivisht në kuotat 55% dhe 18% në 2005. Ndjekja mesatare e shkollës u rrit në 9.6 vite në 2005 (nga 8.6 vite në 2002), që është thuhajse 5 vjet më e ulët se mesatarja OECD. Hendeqe serioze të shkollimit dhe aftësive ekzistojnë midis gjinisë dhe rajoneve (urban/rural). Sidoqoftë, ndjekja e shkollës është rritur lehtësisht, por në përgjithësi nivelet arsimore dhe të aftësive mbeten të ulëta.

Politikat e tregut të punës kanë çuar në disa rezultate inkurajuese nga përpjekjet për formalizimin e punësimit dhe përmirësimin e funksionimit të tregut të punës. Megjithatë, efikasiteti i programeve për tërheqjen e punë-kërkuesve mbeti i kufizuar nga hartimet e pamjaftueshme, mungesa dhe parregullsitë në financime dhe kapacitetet e pamjaftueshme trajnuese. Politikat e tregut të punës në përgjithësi kanë vazhduar të mbajnë një kuadër gjerësisht fleksibël.

Menaxhimi i investimeve publike u kalua nga Ministria e Ekonomisë në një Drejtori të sapoformuar të Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave në 2005. Kjo u bë për të forcuar procedurat dhe kuadrin institucional për planifikimin e menaxhimit të investimeve publike, ekzekutimin dhe monitorimin. Kuadri ligjor shqiptar për prokurimin, privatizimin dhe koncesionet sidoqoftë ka mbetur i dobët. Një rënie e lehtë në investimet publike në 4.6% të PBB-së u balancoi nga rritja përkatëse në investimet private që arritën në 19% të PBB-së në 2005. Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta (FDI) ranë nga 4.6% në 2004 në 3.1% në 2005. Megjithatë, shifra për 2004 u rrit nga privatizimi i Bankës së Kursimeve. Shumica e FDI-së u drejtua në industri (28%), transport (22%), dhe pjesë tjetër në telekomunikacione (18%), sektorin e shërbimeve (17) dhe sektorët e tjerë (15). Formacioni i kapitalit të fiksuar bruto qëndroi stabil në përgjithësi, duke përfaqësues 23.6% të PBB-së në 2005.

Cilësia e rrjetit infrastrukturor ka mbetur e pamjaftueshme duke penguar zhvillimin ekonomik. Sektorët e transportit dhe telekomunikacionit përbënin rreth 36.5% të investimeve totale publike në 2005, me hisen më të madhe (89%) akorduar në infrastrukturën rrugore. Afërsisht 67% e rrjetit rrugor ishte në kushte të këqija ose shumë të këqija në 2005, me 17% në kushte të pranueshme dhe 16% në kushte të mira. Pothuajse 2/3 e investimeve në infrastrukturën rrugore janë akorduar për projekte të shpenzimit të kapitalit të ri dhe vetëm 1/3 për nevojat e mirëmbajtjes dhe riparimit. Kjo e fundit vlerësohet se është vetëm 60% e shumës që nevojitet. Infrastruktura vazhdon të kërkojë investime të konsiderueshme.

Sektori i shërbimeve zinte mbi 54% të PBB-së në 2005, e ndjekur nga bujqësia (23%), industria (14%) dhe ndërtimet (9%). Përqindja e industrisë në prodhimin total u rrit me rreth 3% në 2005. Përqindja e bujqësisë, ndërtimeve dhe shërbimeve në ekonomi, ra me afërsisht 1% të PBB-së për secilën. Ekonomia shqiptare ka vazhduar të jetë e prirur drejt sektorit të shërbimeve, megjithëse sektori bujqësor zë një përqindje të madhe në prodhimin total dhe punësimin.

Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) përbënte rreth 99% të numrit total të sipërmarrjeve private aktive në 2005, doke kontribuar me 64% të PBB-së dhe duke përfaqësues 66% të punësimin total. Aksesit i SME-ve në kreditimin bankar është përmirësuar, por mbetet poshtë nevojave të kërkuara. Mungesa e një raportimi të saktë financiar dhe kontabilist në nivelin e firmës ashtu edhe kreditimi i tepërt dhe risku ligjor që lidhet me shtrëngimin e kolateralit, janë probleme që duhen adresuar. SME-të kanë vazhduar të formojnë pjesën drmmuese të aktivitetit të sektorit privat në Shqipëri.

Performanca operative dhe financiare e një numri ndërmarrjesh shtetërore është fuqizuar⁵. Megjithatë, reformimi i kuadrit të tyre rregullator dhe qeverisës si korporatë nuk është plotësuar. Mangësi të theksuara vazhdojnë të ekzistojnë në sektorin e utiliteteve dhe atë hekurudhor dhe veçanërisht sektori energjetik mbetet një nga faktorët kryesorë të rikut për ekonominë. Për rritjen e furnizimit me energji elektrike në planin afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e performancës financiare të KESH-it, korporatës shtetërore të energjisë, nevojiten masa për të kufizuar impaktet e mëtejshme negative në zhvillimin e ekonomisë nga mangësitë e mëdha të sektorit. Kapacitetet e rrjetit të transmetimit dhe burimet e energjisë alternative ndaj asaj hidrike, janë gjithashtu faktorë kyçë. Përgjithësisht, një shkallë e lartë e dobësisë së sektorit energjetik përbënte një burim të konsiderueshëm risku në zhvillimit ekonomik.

5

Përveç KESH-it, korporatës energjetike, dhe Hekurudhës Shqiptare performance financiare dhe operative e të cilave u përkeqësua ndjeshëm në 2005.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmërinë

Autoriteti i Konkurrencës i ka vazhduar përpjekjet për plotësimin e legjislacionit parësor në fuqi duke nxjerrë një sërë rregulloresh zbatuese dhe udhëzimesh sqaruuese në linjë me parimet e BE-së për konkurrencën. Pas miratimit të Ligjit për Ndihmën Shtetërore në prill 2005, kapacitetet institucionale në këtë fushë u forcuan edhe më tepër me ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore në mars 2006 (një organ vendim-marrës me plotfuqi për të autorizuar çështje individuale dhe skema të ndihmës shtetërore). Në 2005, subvencionet publike përfaqësonin kuotën relativisht të ulët 1.6% të shpenzimeve totale të buxhetit, duke përfaqësuar 0.4% të PBB-së krahasuar me 0.7% të PBB-së në 2004. Progres i mëtejshëm është arritur me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe kuadrit ligjor për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

Integrimi i tregtisë me BE-në

Vlera e eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve u rrit në 67.4% të PBB-së në 2005, krahasuar me 64.7% në 2004. Shqipëria vazhdon të jetë një vend i orientuar drejt importit me një total importiafërsisht 45.8% të PBB-së dhe eksportit total prej vetëm 21.6% të PBB-së në 2005. Hapja e tregtisë është rritur në 2005, por ka mbetur relativisht e ulët. BE vazhdoi të jetë destinacioni kryesor i eksporteve në 2005 me 84% të eksporteve totale. Importet nga BE kanë zënë rreth 70% të importit. Tregtia me vendet e Europës Juglindore është intensifikuar ndjeshëm, e ndihmuar nga marrëveshjet e tregtisë së lirë të përmbyllura në vitet e mëparshme. Eksportet drejt këtyre vendeve u rritën me 19% në 2005 dhe përbënin afërsisht 9% e eksportit total, sipas burimeve vendëse. Importet nga këto vende regjistruan një rritje vjetore prej 32% në 2005 dhe përbënin thuhetse 15% të importeve totale. Në përgjithësi, integrimi i tregtisë me BE-në ka vazhduar të jetë i lartë dhe integrimi në tregtinë rajonale është rritur.

Kursi i këmbimit real të lekut shqiptar përkundrajt euros u rrit lehtë me 3% në 2005, bazuar në çmimet e mallrave të konsumit. Në mungesë të të dhënave të besueshme për koston e punës për njësi dhe përfitueshmëria në sektorët e prodhimit, prirjet për ndryshim në prodhueshmërinë e punës dhe konkurrueshmëria e çmimeve bazuar në koston reale të punës për njësi, janë të vështira për t'u llogaritur.

4. STANDARDET EUROPIANE

This section examines Albania's capacity to gradually approximate its legislation and policies with those of the *acquis* related to the internal market, sectoral policies, and justice, freedom and security, in line with the Stabilisation and Association Agreement and the European Partnership priorities. It also analyses Albania's administrative capacity

4.1. Internal market

4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Paralelisht me angazhimet tregtare, Shqipëria ka ndërtuar detyrime në kuadrin e MSA-së për t'u afruar më tepër me standardet europiane në fushat e standardizimit, metrologjisë, akreditimit, vlersimit të përputhshmërisë dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Progresi ka qenë i konsiderueshëm në fushën e **standardeve dhe certifikimit**. Në mesin e vitit 2006, Shqipëria miratoi 8 348 standarde europiane (EN) që përfaqësojnë 59% të tërës EN të Komitetit Europian për Standardizimin (CEN) dhe Komitetin Europian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC), në linjë

me objektivat e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit dhe Zbatimin e MSA-së. Përparësi vazhdon t'i kushtohet miratimit dhe zbatimit të atyre EN që janë harmonizuar nën direktivat e Përqasjes së Re dhe që japin prezumimin e përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të direktivave. Megjithatë, ministrinë përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit teknik të BE-së kanë qenë të ngadalta në transpozimin e direktivave përkatëse të BE-së.

Për sa i takon vlerësimin të përputhshmërisë, progres është shënuar në fushën e certifikimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Numri i shoqërive shqiptare të certifikuar sipas kërkesave të standardeve ISO 9001:2000 standards, vazhdoi të rritet. Tashmë kanë ngritur organet e para testuese dhe certifikuese, kryesisht në sektorët e mallrave ushqimore dhe ndërtimit. Madhësia e kufizuar e tregut bën që certifikimi i palëve të treta është akoma i zbatueshëm nga ana tregtare.

Progres i mëtejshëm është shënuar në funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (GDS) që është anëtare e afiluar i CEN dhe CENELEC dhe synon të arrijë anëtarimin e plotë nga viti 2008. Ligji i vitit 1999 për Standardizimin është amenduar për të lejuar e një bordi mbikëqyrës të kësaj Drejtorie – për të përfshirë përfaqësuesit e të gjitha grupeve të interesit në Shqipëri - që do të monitorojë aktivitetin e Drejtorisë së Standardizimit dhe rrisë pavarësinë nga Qveria. Një tjetër amendament i propozuar do t'i lejonte Shqipërisë të nisë ndarjen e certifikimit nga aktivitetet e Drejtorisë (objektiv për 2007). Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit e ka rritur bashkëpunimin me ministrinë për miratimin e EN-ve dhe në tërheqjen e statusit të detyrueshëm të standardeve shqiptare që rrjedhin nga dekretet qeveritare. Standardet e detyrueshme ende ekzistojnë për naftën, gazin dhe produktet e prodhimit. GDS ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar sensibilizimin e sektorit privat për përfitimet nga standardizimi dhe certifikimi që ka çuar në rritjen e shitjeve të EN.

Progres është shënuar në fushën e akreditimit. Pavarësisht hyrjes në fuqi të një dekreti qeveritar që ndau akreditimin nga standardizimi në 2004, organi kombëtar akreditues - Drejtorja e Akreditimit (DA) - i filloi operacionet vetëm në 2005. Ndryshimet në stafin e DA-së dhe përmirësimi i infrastrukturës kanë ndihmuar në përshpejtimin e progresit. DA është pranuar si anëtare e asociuar e Bashkëpunimit Europian për Akreditim (EA). Objektivi për të arritur anëtarësimin e plotë në Bashkëpunimin Europian për Akreditim duhet fillimisht të arrihet në fushën e akreditimit laboratorik, e ndjekur nga fusha të tjera. Labororet testuese përfaqësojnë shumicën dërrmuese të klientëve akreditues potenciale për DA-në për momentin. Njohuritë teknike përkatëse të akreditimit dhe përvoja praktike e stafit të DA-së, duhet të zhvillohet më tej. Përgatitjet për ta sjellë në linjë me *acquis* në fushat e standardizimit dhe certifikimit janë në proces.

Progres i kufizuar është arritur në **metrologji**. Strategjia kombëtare për metrologjinë për periudhën 2006-2015 është hartuar dhe do të miratohet deri në dhjetor 2006. Shumica e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DGMC) është trajnuar për çështjet teknike, të menaxhimit dhe cilësisë. Përmirësimi i laboratorëve po realizohet. Një ligj i ri për metrologjinë është miratuar, por ende s'është zbatuar. Dispozitat e këtij projekt-ligji të ri duhet të sigurojnë ndarjen e funksioneve verifikuese dhe certifikuese të metrologjisë ligjore nga aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut. Bashkëpunim më i ngushtë midis grupeve të interesit do të ndihmonte infrastrukturën teknike kombëtare të Shqipërisë, që të funksionojë në mirë. Përgatitjet në këtë fushë kanë filluar.

Progres i kufizuar është shënuar në fushën e **mbikëqyrjes së tregut**. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është rritur në nivelin e drejtorisë, është forcuar dhe mori masa të mëtejshme për të rritur sensibilizimin e publikut për të drejtat e konsumatorit.

Sidoqoftë, niveli i informimit mbetet përgjithësisht i dobët. Shqipëria tani duhet të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe të qartësojë pozicionin e Ministrit të Bujqësisë dhe Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit për të shmangur mbivendosjet ose bosshlëqet në mbulim. Një plan për sjelljen e legjislacionit mbi mbikëqyrjen e tregut me *acquis*, nuk është finalizuar ende. Përgatitjet në këtë fushë mbeten një fazë fillestare.

Progres për t'u vlersuar është arritur në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit**. Përfshirja e Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit në Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregut brenda Ministrisë së Ekonomikë, Tregtisë dhe Energjisë, është një hap pozitiv pasi çështjet zbatuese dhe rregulluese tashmë janë përgjegjësi e një Drejtorie Mbikëqyrëse të ndarë dhe më koherente. Megjithatë, plotfquitë e detajuara ligjore të Departamentit duhet të qartësohen. Aksesit për të gjithë konsumatorët, nuk është vendosur akoma. Vazhdojnë dobësitë në akordimin e burimeve financiare dhe stafit të departamentit. Pritet ende miratimi i një politike të mbikëqyrjes së tregut dhe Strategjisë Kombëtare 2006-2008 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut. Përgatitjet në këtë fushë sapo kanë filluar.

4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes

Shqipëria ka ndërmarrë angazhime të konsiderueshme nën MSA-në për sa i përket lëvizjes së punëtorëve, lirisë së shërbimeve dhe lirisë së vendosjes.

Asnjë zhvillim s'mund të raportohet në fushën e **lëvizjes së personave**. Asnjë progres nuk është bërë në fushën e koordinimit të sistemeve të sigurimeve sociale. Përgatitjet në fushën e lëvizjes së personave, janë në fazën fillestare.

Është shënuar pak progres në fushën e lirisë së **shërbimeve**. Ekonomia e Shqipërisë është relativisht e hapur ndaj kompanive dhe investimeve të huaja, dhe progresi përkatës në lirinë e vendosjes ka impakt pozitiv në këtë fushë. Progres është bërë edhe në sektorin bankar. Investimet nga bankat e huaja kanë pasur impakt pozitiv si në qeverisjen e bankave ashtu edhe dhe cilësinë e shërbimeve, dhe rrjeti bankar është zgjeruar në mbarë vendin. Një ligj i ri bankar është miratuar nga Këshilli i Ministrave në 2006. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për ta sjellë në linjë me standardet europiane. Ka pasur një përmirësim në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave dhe kuadrit të falimentimit, ashtu edhe në shtrëngimin e kolateralit. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, ka filluar fazën e dytë të liberalizimit të shërbimeve postare dhe po përgatit një vendim të Këshillit të Ministrave për liberalizimin gradual.

Kuadri rregullator ka nevojë për miratim në mënyrë që të heq barrierat ligjore për personat ligjorë dhe juridikë të BE-së. Ende s'ka një dalim të qartë, siç kërkohet nga zbatimi i MSA-së, midis operatorëve që japin shërbime në një mënyrë të përkohshme dhe ata që japin shërbime përmes një vendosjeje të përhershme në Shqipëri. Ligji për Shërbimin Postar ende nuk është sjellë në linjë me *acquis*. Një strukturë rregulluese e pavarur në fushën e shërbimeve postare ende nuk është ngritur. Përgatitjet kanë filluar në fushën e lirisë për të dhënë shërbime.

Njëfarë progresi mund të raportohet në lidhje me **të drejtën e vendosjes**. Një Plan Veprimi i ri për Reformën Rregulluese që synon të heqë barrierat administrative, është miratuar nga qeveria. Është hequr diksriminimi në tarifatat e regjistrimit që duhen paguar nga shoqëritë e huaja, në linjë me kërkesat e MSA-së. Procedurat për regjistrimin e bizneseve janë thjeshtuar. Koha për regjistrimin e biznesit u ul nga 42 në 8 dhe qarkullimi i informacionit nga regjistri tregtar në zyrat tatimore, tashmë është i detyrueshëm.

Një ligj i ri ka e ka decentralizuar regjistrin tregtar, duke iu lejuar bizneseve që të regjistrohen në gjykatat e rretheve.

Megjithatë, firmat që duan të vendosjen në Shqipëri, vazhdojnë të hasin në rezistencën e vendosjeve/sipërmarrjeve ekzistuese. Çështja e pazgjidhur e të drejtave të pronësise pengon sigurinë, duke dekurajuar sipërmarrjet/vendosjet (*shikoni Të drejtat ekonomike dhe sociale*). Përgatitjet në fushën e të drejtës për vendosje janë në fazë fillestare në Shqipëri.

Progres i pakët është shënuar në fushën e ligjit për shoqëritë. Ministri i Financave organizoi aktivitete të mëtejshme për trajnimin dhe certifikimin e auditimeve për Llogaritarët e Certifikuar Shqiptarë. Megjithatë, nevojitet përmirësim i konsiderueshëm në zbatimin e standardeve kontabilisite dhe auditimit. Procedurat ligjore midis degëve të administratës që merren me hapjen e bizneseve nuk janë unifikuar akoma. Po bëhen përgatitjet në këtë fushë.

4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Është bërë njëfarë progresi në fushën e lëvizjes së kapitalit. Puna ka filluar në hartimin e Ligjit për Valutën e Huaj për të rregulluar regjimin e lëvizjeve të kapitalit, që synon që gradualisht të liberalizojë llogaritë e kapitalit në linjë me detyrimet e MSA-së. Megjithatë, vazhdojnë kufizimet e theksuara, sidomos në blerjen e pasurisë së paluajtshme nga të huajt, si edhe investimet portofol dhe lëvizje të tjera afatgjata të kapitalit. Ky aspekt ka nevojë për vëmendje për të siguruar përputhshmërinë me detyrimet e MSA-së. Një projekt-ligj për ngritjen e Autoritetet për Mbikëqyrjen Financiare është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ky Autoritet do të ndërmarrë mbikëqyrjen e fundit të sigurimeve dhe pensioneve, duke zëvendësuar ato ekzistuese si Komisioni i Sigurimeve, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe Instituti i Pensioneve Private. Autoriteti do të raportojë te Parlamenti. Krijimi i këtij organi do të forcojë mbikëqyrjen financiare jo-bankare. Agjencitë aktuale mbikëqyrëse janë të dobëta dhe u mungon pavarësia. Banka e Shqipërisë vazhdon monitorimin e kujdesshëm të sektorit financiar. Në këtë fushë, Shqipëria ka filluar të përgatisë pikat përparësore, që pjesërisht lidhen me angazhimet e bëra nga MSA.

Progres është aritur në fushën e sistemit të pagesave. Sistemet e automatizuara të pagesave po zhvillohen akoma, por paraja mbetet mjeti kryesor i realizimit të pagesave në Shqipëri. Zyra e Postës siguron shërbime për pagesa brenda vendin në vlera të vogla dhe disa operatorë transfertash të parave janë të specializuar në shërbimet ndërkufitare. Banka e Shqipërisë vazhdon të operojë një sistem për Rregullimin Bruto në Kohë Reale për pagesat ndërbankare, Sistemin e Pagesës Albania Interbank (AIPS). AIPS u ngrit për të siguruar përpunim në kohë reale dhe dhënie të pagesave me vlera të larta. Banka gjithashtu ofron shërbime likuidimi për pagesat me pakicë, aktualisht për urdhrat për pagesa dhe çeket. Një shtëpi e automatizuar likuidimi sapo është përfunduar, me shuma dhënëse që llogariten nga një bazë neto shumëpalëshe. Megjithatë, pavarësisht disa premisa për karta individuale të lidhura me sistemet ndërkombëtare, infrastruktura e kartave ende nuk lejon bashkëveprimin e plotë. Reformat në fushën e sistemeve të pagesave mbeten në fazat fillestare.

4.1.4 Doganat dhe tatimet

Progres i kufizuar është arritur në fushën e rregullave doganore. Çmimet e referencës janë vendosur së fundmi dhe vlerat e transaksionit refuzohen në 20% të rasteve. Zbatimi i legjislacionit dhe vlerësimit në dogana duhet të vihet në linjë me parimet e Bankës Botërore të Tregtisë dhe metodologjinë e Nomenklaturës së Kombinuar GATT 2005, por në përputhje me Marrëveshjen e Ndërmjetme, versioni

i fundit i Nomenklaturës së Kombinar duhet të aplikohet për klasifikimin e mallrave në tregti midis palëve që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Nevojitet përputhje e mëtejshme me legjislacionin dhe procedurat e BE-në, sidomos në fushat e procedurave të thjeshtuara doganore dhe procedurat e transitit, magazinat doganore (legjislacioni i ri në këtë fushë është më larg *acquis* se ligji i mëparshëm) dhe informacioni detyrues mbi tarifatat. Në këtë fushë, Shqipëria ka filluar përgatitjen.

Progres domethënës është arritur në **forcimin e kapaciteteve administrative dhe** operative të doganave. Në 2005, Administrata Doganore mbledhi 108% të planit të të ardhurave. Kjo prirje pozitive u konfirmua në gjysmën e parë të 2006-ës. Progres i konsiderueshëm është bërë në zbatimin e deklaratave doganore të kompjuterizuara ASACYDA dhe sistemin e përpunimit. Mbi 95% e të gjitha deklaratave doganore tashmë përpunohen automatikisht nëpërmjet ASYCUDA-s. Moduli i selektivitetit i ASYCUDA-s është zbatuar dhe një sistem i analizës së riskut është bërë funksional në magazinat doganore në Tiranë dhe Durrës.

Progres është shënuar në kontrollin dhe menaxhimin e origjinës. Autoriteti doganor ka një faqe zyrtare ku përfshihen marrëveshjet e tregtisë së lirë të nënshkuara nga Shqipëria. Një program trajnues vjetor bazuar në nevojat e administratës është hartuar për 2006. Rritja e rrogave bazë të miratuar nga Këshilli i Ministrave është një hap pozitiv përpara në përballjen me korrupsionin administrativ. Njëfarë progresi është arritur në rolin e shërbimit doganor në luftën kundër krimit të organizuar, drogës dhe kontrabandës. Dega detare e Doganave po riaktivizohet dhe godina është forcuar dhe shumë aksione efikase janë marrë. Një forcë e përbashkët me policinë tashmë është operative.

Lëvizjet e mëdha të stafit kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm, pasi 90% e të gjithë stafit menaxhues kanë ndryshuar që nga mesi i vitit 2005. Mbrojtja e të drejtave për punësim të oficerëve është reduktuar pas ndryshimeve në kuadrin ligjor për personelin. Të gjitha autorizimet për magazinat doganore janë revokuar, që është dëmtuese për tregtarët e ndershme. Përpjekje të mëtejshme envojitetin për kontrollin efikas të IPR dhe mallrat për përdorim të dyfishtë (dual-use). Përmirësimi në menaxhimin e origjinës, duhet të vazhdojë. Infrastruktura doganore, veçanërisht godina doganore e Tiranës, ka nevojë për përmirësim urgjent. Një sistem efikas doganor është jetik për zbatimin e Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe MSA-së. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e doganave kanë avancuar lehtësisht.

Progres është shënuar në fushën e **tatimeve**. TVSH u fut në 1996 dhe përqindja e TVSH-së është 20%. Është thjeshtuar rimbursimi i TVSH-së për eksportet duke mos kërkuar më një dokument importi të vendit importues. Koha e pritjes për pagesën e TVSH-së është zvogëluar dhe është përgatitur një plan i përgjithshëm auditimi për 2006. Disa modifikime i janë bërë sistemit të TVSH-së, veçanërisht përjashtimet. Shitja e shtëpive të reja tashmë është përjashtim, ashtu edhe e sipërmarrjeve të lojërave të fatit. Një sistem i analizës së riskut po futet për zbatimin e TVSH-së.

Përqindja e taksave nga të ardhurat (fitimi) është ulur nga 23% në 20%. Përqindja e taksës për bizneset e vogla është ulur nga 3% në 1.5%. Numri i shkallëve tatimore për të ardhurat personale është zvogëluar nga gjashtë në katër, dhe përqindja maksimale është ulur nga 25% në 20%. Është rritur përqindja e mbledhjes së tatimeve. Porecdura e re e apelimit i lejon sektorit të biznesit të përfaqësohet në komisionin që merret me ankesat. Kompjuterizimi i zyrave tatimore po shënon progres të mëtejshëm dhe një rrjet i ri po futet, që mbullon 12 zyra tatimore rrethesh (përfshi 80% të taksapaguesve). Kontrabanda e mallrave të akcizës duket se po pakësohet. Reformat tatimore në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë duhet të fillojnë, veçanërisht duke marrë në konsideratë direktivat e taksës së shoqërisë. Një Model Traktat bazuar në modelin e fundit të OECD. Autoritetet shqiptare ende s'kanë ndërmarrë një analizë për identifikimin e masave të dëmshme ekzistuese të cilat mund të kundërshtojnë parimet e Kodit të Sjelljes në tatimit e

biznesit. Një strategji gjithëpërfshirëse e mbledhjes së taksave dhe kontrollit, nuk është miratuar akoma. Këtu duhet të bëjë pjesë edhe rishikimi i rolit dhe funksionit të Policisë Tatimore.

Në përgjithësi, nevojitet sjellja në linjë me legjislacionin e BE-së dhe praktikat më të mira. Madhësia e ekonomisë informate (grey) dhe lufta kundër mashtrimit, kërkojnë vëmendje të mëtejshme. Lëvizjet e shumta të stafit në administratën tatimore, do të thotë se njohuritë e akumuluar duhet të rivendosen. Ligjet e reja kufizojnë garancitë e punësimit për stafin, duke i bërë edhe më të përkulshëm ndaj trysnive të jashtme.

Në përgjithësi, përgatitjet në këtë fushë po fillohen.

4.1.5. Konkurrenca

Njëfarë progresi është shënuar në fushën **anti-trust**. Autoriteti i Konkurrencës (ACA) ka lëshuar rregullore dhe udhëzime sqaruese mbi kontrollin e përqendrimeve, imunitetin nga gjobot si dhe marrëveshjet horizontale dhe vertikale. Gjithashtu ka filluar të vlerësojë shkrirjet dhe blerjet që i njoftohen. Për sa i përket vënies në zbatim, ACA po procedon me dy dosje të mëdha, në lidhje me respektivisht telefoninë celulare dhe sigurimin e makinave në pikë-kalimet kufitare

Progres është bërë në funksionimin e ACA-s. Anëtarët e stafit janë trajnuar dhe takime rajonale për rritjen e sensibilizimit janë mbajtur për komunitetin e biznesit. Megjithatë, ende s'është e qartë deri në çfarë shkalle Autoriteti i Konkurrencës mund të punojë i pavarur. Shumica e stafit është rekrutuar së fundmi dhe kështu që janë të papërvojë, dhe mungesa e burimeve do të thotë se objektivat për plotësim me staf, nuk janë përmbushur. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmirësimin e efikasitetit të kontrollit të konkurrencës. Shqipëria ka ndërmarrë angazhime të mëdha në këtë fushë në kuadrin e MSA-së. Përgatitjet në këtë fushë po lançohen.

Progres thelbësor është arritur në fushën e **ndihmës shtetërore**. Përkthimi në shqip i Rregulloreve përkatëse të BE-së, ka përfunduar. Në dhjetor 2005, Këshilli i Ministrave kompletoi kuadrin ligjor në fushën e ndihmës shtetërore duke miratuar kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës rajonale dhe ristrukturuese. Është instaluar një sistem për njoftimin elektrktonik për autorizim, dhënie dhe kontrollim të ndihmës shtetërore. Inventari i ndihmës shtetërore është përfunduar dhe përmban të dhëna të ndihmës shtetërore të dhëna që në 2005.

Një Komision i Ndihmës Shtetërore është krijuar si organ vendim-marrës në këtë fushë. Ai ka plotfuqinë për të autorizuar skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale, si edhe të urdhërojë tërheqjen e ndihmës së papërputhshme. Komisioni përmban profesistë në fushën e të drejtës dhe ekonomisë të cilët përfaqësojnë shoqërinë civile ose institucionet që nuk janë të përfshira drejtpërdrejt në dhënien e ndihmës shtetërore. Departamenti i Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, vazhdon të jetë operativ si një organ administrativ që i raporton drejtpërdrejt Komisionit. Trajnim u është siguruar përfaqësuesve të administratës qendrore dhe vendore mbi kuadrin e ri ligjor dhe institucional për ndihmën shtetërore dhe detyrimet e tyre ligjore.

Kjo fushë ka bërë progres të shpejtë dhe është zhvilluar ekspertizë e konsiderueshme. Sfidat e radhës për autoritetet shqiptare është të ndërthurë më mirë departamentin e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe të qartësojë vizën ndarëse operative raportuese nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore. Përgatitjet janë në rrugën e duhur drejt përmbushjes së angazhimeve të MSA-së në fushën e ndihmës shtetërore.

4.1.6 *Prokurimi publik*

Progres të kufizuar ka pasur në fushën e prokurimit publik. Në MSA, Shqipëria është angazhuar që të bëjë përafrimin me *acquis* në këtë fushë. Progresi në këtë fushë është gjithashtu jetik për përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik, një përparësi e Partneritetit European. Një ligj i ri që merr parasysh parimet dhe shumicën e procedurave të përcaktuara në direktivat e BE-së, pret miratimin në parlament. Njëfarë preograsi është arritur për sa i takon organizimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (PPA). Kurset trajnuese njohëse mbi prokurimin publik janë zhvilluar për institucionet qendrore zyrtarët e qytetit. Një njëis trajnimi është ngritur në mënyrë që të bëjë ndërlidhjen me organet publike në aktivitetit e prokurimit në mbarë vendin, përfshi edhe ministrinë e linjës. Agjencia ka krijuar një faqe të re interneti për të rritur transparencën.

Legjislacioni aktual për prokurimin publik jo vetëm që nuk ofron një kriter specifik për identifikimin e oferta të ulëta, as nuk lejon përdorimin e kriterit të ofertë ekonomike më të favorshme. Në mungesë të një organi të pavarur për ankesat, efikasiteti dhe pavarësia e procedurave të shqyrtimit nuk mund të garantohet. Influenca politike dhe korrupsioni mbeten subjekt hetimesh të pamjaftueshme dhe ndjekesh penale për shkeljet në prokurime. Mungesa e transparencës vazhdon të rezultojë pengesë në promovimin e konkurrencës brenda sektorit privat, gjë që sjell që avantazhet kyçe t'i kenë një numër i vogël operatorët ekonomikë lokalë. PPA mbetet e dobët dhe me mungesë fondesh, me staf të pamjaftueshëm dhe pak qartësi në atribuimin e detyrave. Stafi i lëvizur së fundmi nga nivelet e mesme dhe të larta menxhuese, duhet të zëvendësohen.

S'është shënuar progres i veçantë në procedurat e prokurimit. Përdorimi i procedurës së tenderimit të drejtpërdrejtë nga entet prokurorese, vazhdon të jetë tepër i shpeshtë. Këshilli i Ministrave e ka rritur edhe më shumë vlerën prag për tenderimin e kontratave për ndërtimet, duke e thelluar edhe më tej distancën midis kërkesave të BE-së dhe Shqipërisë. Në dhënien e kontratave publike, entet prokurorese ende caktojnë tendera në bazën e çmimit më të ulët. Në fushën e prokurimit publik, Shqipëria po mbetet mbrapa.

4.1.7 *Ligji i pronësisë intelektuale*

Proges i kufizuar është shënuar nga Shqipëria për sa i takon **të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR)**. Sipas MSA-së, Shqipëria duhet të përafrojë *acquis* në këtë fushë dhe të ofrojë një nivel të lartë të mbrojtjes së IPR. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është zhvendosur nga Këshilli i Ministrave te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Council of Ministers to the Ministry of Economy, Trade and Energy. Në stafin prej 13 vetash të Drejtorisë, bëjnë pjesë 6 specialistë të Pronësisë Intelektuale (IP). Drejtoria në mënyrë periodike publikon buletine informative mbi patentat dhe markat me qëllim rritjen e sensibilizimit publik. Shqipëria e ka nënshkruar marrëveshjen e Strasburgut mbi klasifikimin ndërkombëtar të patentave. Një bazë të dhënash ku përfshihen të gjitha markat e regjistruara, patentat dhe dizenjat industriale që nga 1994, tashmë është funksionale procedurat janë automatizuar, por ende ka vonesa në publikimin e të drejtave të regjistruara. Në fushën e pronësisë industriale, u nënshkrua me Zyrën Shtetërore të Pronësisë në Rep. Ish-jugollsave të Maqedonisë një marrëveshje për shkëmbim informacioni mbi legjislacionin, publikimet dhe trajnimet.

Është ngritur zyra për të drejtën e autorit e parashikuar nga ligji i vitit 2005 për drejtën e autorit dhe të drejtat që lidhen me të, por s'është operative, çka pengon zbatimin e konventave ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria. Menaxhimi kolektiv i të drejtave është jo-efikas për shkak të mungesës së

burimeve dhe kapaciteteve. Mbledhja e të ardhurave nga ekskluzivitet (royalties) është e rrallë dhe shoqëritë mbledhëse rrjedhimisht kanë nevojë për asistencë nga organizatat simotra në pjesë të tjera të Europës që të përballojnë kostot e tyre. Pirateria dhe falsifikimi vazhdojnë të jenë të përhapura. Ka një mungesë të përgjithshme të sensibilizimit për shkeljet e Pronësisë Intelektuale (IP) si edhe për efektet dëmtoese sociale dhe ekonomike të falsifikimit në radhët e organeve të rendit si edhe të gjyqësorit. Përgatitjet në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale janë në fazë fillestare.

Shumë pak progres është arritur në **zbatimin** e IPR-së në Shqipëri. Trajnime të mëtejshme u janë siguruar gjyqtarëve dhe avokatrëve. Një njësi e specializuar për IPR është ngritur brenda departamentit investigativ të administratës doganore. Megjithatë, kapacitetit institucionale dhe bashkëpunimi mbeten të dobëta, dhe aksionet zbatuese rrjedhimisht janë të rralla. Gjykatat shqiptare tregojnë përvojë dhe kualifikime të pamjaftueshme në këtë fushë, dhe nuk ekziston asnjë gjyqtar i specializuar apo gjykata ekskluzive për çështje pronësie intelektuale. Në këtë fushë, vendi përmbush objektivat vetëm pjesërisht.

Në fushën e IPR-së si e tërë, përgjegjësitë e qeverisë mbeten shumë të fragmentuara, dhe kërkohet një strategji kombëtare koherente. Puna drejt përmbushjes së angazhimeve të MSA-së është në fazë fillestare.

4.1.8. *Politikat sociale*

Politikat e punësimit

Vetëm një progres modest është arritur në fushën e punësimit. Një sërë programesh për nxitjen e punësimit janë zbatuar në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social. Megjithatë, ndikimi i tyre ka qenë i kufizuar nga mungesa e vlerësimit të saktë. Sfidat për Shqipërinë është që tashmë të shfrytëzojë si duhet krahun e punës në rritje duke përdorur një përjasje shumë-sektoriale për të stimuluar mundësitë për punë. Çështjet thelbësore legjislative dhe rregulluese mbeten krijimi i një kuadri modern ligjor për ligjin e punës, shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe zbatimi i tij, krijimi i një inspektorati pune për të gjithë vendim, reforma në sistemin e pensioneve dhe mbrojtjes sociale si dhe zhvillimi i dialogut social.

Duhet të forcohen politikat për barazinë gjinore, veçanërisht forcimi i Komitetit Shtetëror për Mundësi të Barabarta dhe zbatimi i plotë i ligjit për Barazinë Gjinore (*shikoni edhe kapitullin e të Drejtave Politike, Ekonomike dhe Sociale*)

Shqipëria është në hapat fazën fillestare në këtë fushë.

Arsimi

Progres i pjesshëm është arritur në fushën e arsimit fillor dhe dytësor. Strategjitë kombëtare për arsimin para-universitar dhe formimin profesional para-universitar deri në 2015, janë miratuar. Prezantimi i një skeme të re për konkurset përfundimtare dhe konkurset e pranimit në universitetet shqiptare (Matura Shtetërore), ka qenë një zhvillim pozitiv. Një skemë pilot për shërbimet psikologjike ka filluar në shkollat dytësore. Përdorimi i teksteve shkollore ka qenë i liberalizuar, duke i dhënë mundësi mësuesve që të kenë disa materiale të kompletueshme për të njëjtën lëndë.

Progresi ka qenë i kufizuar në fushën e arsimit të mesëm. Për shembull, një grup pune është ngritur për hartimin e një ligji të ri për të siguruar ndjekjen e procesit të Bolonjës. Të gjitha institucionet kanë filluar

zbatimin e procesit të Bolonjës dhe Transferimit European të Krediteve dhe është edhe Sistemi i Akumulimit. Disa masa janë marrë për të rritur rrogat në sistemit e arsimit publik.

Pavarësisht disa prirjeve pozitive së fundmi (*shikoni Arsimin nën të Drejtat Ekonomike dhe Sociale*) see Education under Economic and Social Rights), përqindjet e pjesëmarrjes në arsim mbetet më të ulëta se mesatarja e BE-së dhe vendeve të tjera të rajonit në të gjitha nivelet arsimore, por veçanërisht në nivelin dytësor. Fëmijët në zonat rurale dhe vajzat janë veçanërisht të disavantazuar. Braktisja e shkollës në vitet e fundit të arsimit fillestar është e lartë, dhe një përqindje e madhe fëmijëve e lënë sistemit shkollor pa marrë asnjë kualifikim. Mungesa e aftësive nuk duhet se po e pengon zhvillimin e ekonomisë shqiptare, por boshllëqet në aftësi teknike por raportohen nga punëdhënësit në zona urbane ku aktiviteti ekonomik është më vibrues. Në planin afatmesëm, nivelet e ulëta të aftësive kërcënojnë investimet dhe zhvillimin e industrive me vlerë të lartë të shtuar si dhe shërbimet. Përgatitjet e Shqipërisë në fushën e arsimit janë në fazën fillestare.

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1 Industria dhe SME

Njëfarë progresi është arritur drejt përmirësimit të mjedisit të biznesit për industrinë dhe SME-të. Në tetor 2005, task forca ekzistuese për reformën rregulluese me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, u ri-miratua nga një qeveri e re. Qeveria ka miratuar një plan veprimi të rishikuar për heqjen e barrierave administrative për bizneset. Legjislacioni tregtar është përmirësuar duke ulur kohën për regjistrimin e biznesit deri në 8 ditë.

Shqipëria ka filluar të reformojë regjimin tatimor dhe barrën fiskale për SME-të. Shkalla e taksës nga fitimi i thjeshtuar për SME-të, pagesa e të cilës kërkonte paragimin e pafavorshëm tremujor, është ëulur në 50% dhe afatet e pagesave janë përmirësuar për të ulur shmangjen e taksës. Sipas të dhënave statistikore shqiptare, Shqipëria ka pasur një rritje të dukshme të regjistrimeve të shoqërive të reja (9 000 në nëntë muajt e parë të 2006-ës) pjesërisht falë një regjimi më të favorshëm tatimor.

Janë identifikuar hapat për zbatimin e planit të veprimit për pakësimin e ekonomisë informate, si për shembull thjeshtimi i licencave, lejeve dhe certifikatave, por progresi konkret mbetet i ngadaltë. Nuk ka pasur progres deri tani në ngritjen e procedurave zyrtare për vlerësimin të biznesi të masave të planifikuara rregulluese, por qeveria synon të fusë këto lloje vlerësimesh deri në dhjetor 2006.

Kapacitetet e Shqipërisë për bërjen e politikave tregtare, mbeten të dobëta. Sekretariati i saj i Organizatës Botërore të tregtisë në Departamentin e Bashkëpunimit Ekonomik dheë Tregtisë, tashmë iu quajtur Sektori i Marrëdhënieve me OBT-në dhe Bashkëpunimit Ekonomik, ende ka mungesë stafi.

Qeveria ka vendosur një organizatë të re çadëdr, Albinvest, që integron Agjencinë Shqiptare të Investimeve (ANIH), Agjencinë e Sipërmarrjeve të Vogla (SMEA) dhe Agjencinë Shqiptare të Eksporteve (ANE) dhe raporton drejtpërdrejt të Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kjo strukturë e re është në linjë me politikën qeveritare për të ulur kostot operative të administratës publike dhe pritjet të forcojë qëndrueshmërinë. Aftësia e Albinvestit për t'u siguruar asistencë efikase investitorëve të huaj transitorë (one-stop shop), aktualisht po testohet nga një numër në rritje misionesh të tregtisë dhe investimeve që vizitojnë Shqipërinë.

Agjenciu e re ka trashëguar ambientet dhe stafin e organeve të mëparshme, por pritet ende vendimi i Këshillit të Ministrave për strukturën e brendshme organizative të agjencisë.

Regjistrimi i shoqërive dhe sistemi i ngritjes ende mbetet i ngadaltë, burokratik dhe jo-efikas. Procesi i përgjithshëm i regjistrimit dhe ngritjes (set-up) akoma përmban 7 hapa (11 përfshi licencat e detyrueshme) dhe një kohë mesatare prej 41 ditësh. Nuk ka regjistrim “on-line” dhe as parim heshjtja-është-miratim. Hapa konkrete për forcimin e Këshillit Këshillues të Biznesit mbeten për të ndërmarrë. Nuk ka zhvillime në inkubatorët e biznesit apo parqet teknologjike. Shqipëria ka miratuar një ligj për “e-signature”.

Pak progres është bërë në fushën e financimit të SME-ve. Ligji i ri i huadhënies, i miratuar në 2005, tashmë po zbatohet si një alternativë financuese për SME-të. Italia dhe Shqipëria kanë përfunduar një marrëveshje për ngritjen e një ndërtesë kreditimi për SME me 30 milion EUR, por ngritja e saj është vonuar për dy vjet. Pavarësisht njëfarë progresi në procedurat për vendosjen e një fondi garancie për SME, vazhdon të jetë seriozisht i vonuar dhe ende nuk është operativ. Progresi i Shqipërisë në zbatimin e Kartës Europiane për Sipërmarrjet e Vogla ka qenë relativisht i ngadaltë. Ende ka pak prova që njohuritë e sipërmarrjes po përfshihen në sistemet arsimor dhe profesional dhe nuk ka pasur një futje të ndjeshme të sipërmarrjes në kurrikula.

Shqipëria është në fazat fillestare në përmirësimin e mjedisit të aibznesit për industrinë dhe SME-të.

4.2.2. *Bujqësia dhe peshkimi*

Progresi në **bujqësi** ka qenë shumë i kufizuar. Investimet në plantacionet e drurëve frutore, vreshtave dhe industrinë e përpunimit të ushqimeve, janë rritur. Bankat tregtare kanë luajtur rol pozitiv në sigurimin e kredive për industrinë e përpunimit të ushqimeve. Është rritur shitja e perimeve dhe qumështit në industrinë e përpunimit, duke përmirësuar të ardhurat e fermerëve në këto fusha. Strategjia e zhvillimit bujqësor dhe rural e Ministrisë së Bujqësisë, është miratuar nga qeveria.

Megjithatë, prodhueshmëria e përgjithshme mbetet e ulët dhe Shqipëria nuk është në gjendje të konkurrojë me produktet e importuara bujqësore. Pavarësisht përmirësimit në bilancin e tregtisë së ushqimeve, (përfshi ushqimet e përpunuara), importet në sektorin e gjësë së gjallë vazhduan të rriten, që i atribuohet kryesisht përmasave teper të vogla të fermave mesatare dhe nënvizon nevojën për konsolidimin e fermës. Roli i industrisë vendëse në promovimin e rritjes bujqësore, ka qenë i kufizuar.

Regjistrimi i vonuar i tokës si dhe kthimit dhe kompensimit të pronave, mbetet një vështirësi e madhe pasi titulli i përcaktuar dhe i qartë ligjor për tokën, është jetik për progresin në këtë sektor. Kanalet shpërndarëse ende kanë nevojë për përmirësohen dhe të sigurohen magazina të përshtatshme për prodhimet. Përgatitjet në këtë fushë të bujqësisë janë akoma në një fazë fillestare.

Njëfarë progresi, por i pabarabartë, është arritur në fushën **veterinare dhe fitosanitare**.

Nuk ka pasur progres në sjeljen e standardeve të prodhimit fitosanitar dhe veterinar në përputhje me kërkesat e BE-së, edhe për ato me potencial të fuqishëm eksportues, si për shembull molusqet bivalvore.

Njëfarë progresi është shënuar në sektorin veterinar. Autoritetet shqiptare kanë marrë masa për transpozimin e disa pjesë të *acquis*. Po ngrihet një sistem për kontrollin e sëmundjeve dhe monitorimin e lëvizjeve të brejtësve të vegjël. Megjithatë, asnjë progres s’ka pasur në qartësimin e kompetencave të

shërbimeve veterinarë, forcimin e strukturave të kontrollit apo të kapaciteteve të stafit. Për më tepër, vazhdon mungesa e transparencës në qasjen e sëmundjeve të kafshëve, siç u shfaq së fundmi nga rastet e gripit të shpendëve. Pa paragjykuar rritjen e nevojshme të stabilimenteve për përpunimin e ushqimit që të përmbushin kërkesat e BE-së, Ministria duhet të përgatisë një plan për përmirësimin e stabilimenteve përkatëse në sektorin e peshkimit pas një misionit të Zyrës së Ushqimit dhe Veterinarisë (FVO) mbi peshqit dhe molusqet bivalvore. Fermat e peshkut regjistrohen dhe kontrollohen nga Autoriteti Kompetent (CA). Megjithatë, standardet ligjore ekuivalente me kërkesat e BE-së, ende mungojnë. Autoriteti Kompetent ka nevojë që laboratorët zyrtarë të kenë akses që të jenë në gjendje të kryejnë diagnostikimin e të gjitha sëmundjeve të peshqve dhe rrjedhimisht nuk është në gjendje të certifikojë përputhshmërinë me kërkesat e BE-së. Misioni FVO theksoi mangësitë në disa stabilimente të akua-kulturës të miratuara për eksport drejt BE-së. Kjo rrit shqetësimin mbi aftësinë e CA-së për të siguruar standardet e duhura për ambalazhimin higjienik dhe kryerjen e vlerësimeve të sakta. U nënvizua gjithashtu edhe mungesa e kontrolleve zyrtare në përdorimin e drogave veterinarë në akua-kulturë. Për më tepër, disa standarde ligjore as nuk aplikohen nga operatorët e biznesit të ushqimeve dhe as nuk kërkohen nga CA. Edhe pse aktualisht nuk ka eksport produkesh të akua-kulturës drejt BE-së, dështimi i CA-së për të zbatuar monitorimin e fermave të peshkut në 2005, shoqëruar me mungesën e kontrolleve në përdorimin e medikamenteve veterinarë, minon aftësinë e CA-së për të garantuar statusin përfundimtar të produkteve të akua-kulturës.

Progresi ka qenë i kufizuar në kontrollin fitosanitar. Shqipëria u bë anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar për mbrojtjen e varieteteve të reja bimore (UPOV) në tetor 2005. Disa akte nënligjore janë ëprgatitur, por do të zbatohen vetëm pas mendimit të Ligjit për Shërbimet e Mbrojtjes së Bimëve. Për sa i përket kapaciteteve administrative, përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës laboratorike - sidomos me pajisje dhe trajnime – ka vazhduar. Sidoqoftë, niveli i stafit teknik ende nuk është në lartësinë e kërkuar për zbatimin e legjislacionit të BE-së.

Fusha e politikës veterinarë dhe fitosanitare është jetike për shfrytëzimin e suksesshëm të kushteve tregtare nga MSA dhe Marrëveshja e Ndërmjetme. Përgatitjet në këtë fushë janë ende në një fazë fillestare.

Pak progres është bërë në fushën e **peshkimit**. Në lidhje me progresin e administrimit përkatës drejt standardeve europiane në fushën e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, Shqipëria merr pjesë në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit të FAO për Mesdheun dhe ka ndërmarrë angazhime për zbatimin e rekomandimeve të tij. Sidoqoftë, dëmtimi i stokut nëpërmjet mjeteve të paligjshme, vazhdon. Bashkëpunimi me policinë për inspektime në det duhet të forcohet.

Është në interesin e Shqipërisë që të bëjë progres në fushën e peshkimit, me synimin që të përfitojë nga preferencat tregtare që BE i jep në kuadrin e MSA-së dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme. Përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë fillestare.

4.2.3 *Mjedisi*

Progresi ka qenë i kufizuar në përpjekjet e Shqipërisë për të përafuar sektorin e mjedisit me standardet europiane.

Në lidhje me **legjislacionin horizontal**, njëfarë progresi është bërë. Është miratuar një Ligj për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit. Prirjet e fundit kanë konfirmuar rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet e mjedisit. Qeveria e re ka shfaqur predispozitën që të të respektojë dispozitat e

Konventës Arhuus dhe Ligjit Kombëtar për Mjedisin, veçanërisht për informimin e publikut. Megjithatë, Ligji Kombëtar për Mjedisin nuk është rishikuar akoma. Përgatitjet në këtë fushë po lançohen.

Ka pasur njëfarë progresi në fushën e **menaxhimit të mbeturinave**. Një Ligj për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme është miratuar. Megjithatë, infrastruktura e përshtatshme dhe politikat për inkurajimin e seleksionimit, mbledhjes dhe largimit të mbeturinave, mungojnë akoma. Ka filluar riciklimi i disa mbetjeve të forta nga ana e sipërmarrësve private, por masat dhe politikat për inkurajimin e riciklimit mbeten për t'u miratuar. Puna ka vazhduar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme në Porto Romano (impiant kimik dhe zonë magazinimi). Puna po vazhdon për të ndaluar ndotjen nga mërkur në impatin e plastikës në Vlore, për të larguar solucionin arsenik nga Impianti i Azotit në Fier dhe për të ndaluar ndotjen e Rafinarinë e Naftës së Ballshit dhe gropave të Sharrës. Nisur nga kundërshtimi vendor i hapjes së gropave për hedhjen e mbeturinave të rrezikshme në Patos-Marines, duhet të bihet dakord urgjentisht për plane alternative. Përgatitjet në fushën e menaxhimit të mbeturinave kanë vazhduar në Shqipëri.

Asnjë progres i veçantë nuk është arritur për sa i përket **cilësisë së ujit**. Pavarësisht disa investimeve për trajtimin e ujërave bashkiake, ndotja e ujit mbetet një problem serioz, veçanërisht në ujin e plazhit. Përveç kësaj, vazhdon problemi i hedhjes në det të sasive të mëdha materialesh interte. Nuk ka pasur ulje në nivelin e ndotjes së ujit nga aktivitetet industriale, veçanërisht nga nxjerrja e naftës. Sistemet e ujësjellësit dhe sistemit sanitar, vazhdojnë të jenë të vjetruara. Nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse e menaxhimit të ujit, përfshi përafrimin me standardet legjislative europiane, përcaktimin e nevojave investuese dhe përmirësimin e kapaciteteve ministrore dhe vendore për menaxhimin e çështjeve të ujit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Shqipëria po mbetet mbrapa në këtë fushë.

Progres nuk është bërë në fushën e **cilësisë së ajrit**. Cilësia e karburanteve mbetet një problem i madh. Për s i përket zbatimit të udhëzimeve të përbashkëta të zhvilluara në 2004 për kontrollin dhe nivelet e lejueshme të ndotësve ajrore nga automjetet, shumë automjetet normalisht nuk duhet të lejohen që të qarkullojnë pa bërë riparimet e nevojshme që të jenë brenda niveleve ligjore të ndotjes. Shqipëria po mbetet mbrapa në këtë fushë.

Progresi në fushën e **mbrojtjes së natyrës** ka qenë i kufizuar. Prerja e paligjshme e drurëve mbetet problem në vend, ashtu si mungesa e politikave inkurajuese për komunitetin vendor për pyllëzimin e shpateve dhe zonave të gërryera. Në lidhje me zbatimin e konventave përkatëse ndërkombëtare, një Ligj për Biodiversitetin është miratuar nga parlamenti. Megjithatë, mbeten për t'u zbatuar rregulloret përkatëse. Në përgjithësi, Shqipëria duhet të forcojë bashkëpunimin midis ministrive dhe agjencive qeveritare për këtë çështje. Shkurtime të buxhetore në kostot administrative kanë paralizuar aftësinë e inspektorëve për të shtrënguar zbatimin e rregullave. Shqipëria është në fazë fillestare në këtë fushë.

Progres i pakët është bërë në fushën e **kimikateve dhe organizmave të modifikuar gjenetikut** (GMO). Një projekt-ligj me dispozita për GMO pritet të miratohet nga parlamenti. Shqipëria është në fazë fillestare në këtë fushë.

Progres është bërë në fushën e kapaciteteve administrative. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MEFVA) ka pësuar ristrukturim duke formuar Drejtori për politika specifike. Kjo strukturë e re ka rritur përgjegjësitë e saj dhe ka fokusuar përpjekjet për forcimin e zbatimit të ligjit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, integritetit mjedisor dhe përafrimit të kuadrit ligjor me standardet e BE-së. Trajnimi stafit ministrot po vazhdon. Objektivat kryesore mbetet forcimi i

politikë-bërjes për mjedisin dhe sektoriale, si edhe zbatimi i politikave qeveritare të kontrollit në fushat nën përgjegjësinë e MEFVA-së, pasi kjo do të ndihmojë Shqipërinë që të përmbushë kërkesat e MSA-së. Përcaktimi i përgjegjësiave të institucioneve të tjera për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin, mbetet ende pezull. MEFVA duhet të vazhdojë përpjekjet për forcimin e koordinimit me ministrinë e tjera dhe qeverisjen vendore dhe të integrojë një politikë mjedisore në politikat e fushave të tjera. Përpjekje të mëtejshme kërkohen për zbatimin e legjislacionit të mjedisit për Vlerësimin e Impaktit. Mbledhja dhe niveli i gjobave që u vihen kundravajtëse të legjislacionit për mjedisin, mbeten tepër të kufizuara dhe jo-bindëse. Plani Kombëtar i Mjedisit për Përafrimin e Legjislacionit është miratuar dhe është përfshirë në Strategjinë e re Kombëtare për Mjedisin që pritet të miratohet brenda 2006-ës. Përgatitjet në këtë fushë janë në proces. Progresi i kufizuar është bërë drejt ratifikimit dhe zbatimit të konventave përkatëse ndërkombëtare në fushën e mjedisit, prandaj duhen përpjekje të mëtejshme.

4.2.4. *Politika e transportit*

Është shënuar njëfarë progresi në fushën e politikës së transportit. Plani Kombëtar i Transportit (ANTP) tashmë është miratuar. Ai shtrihet udhëzimet dhe rekomandimet për zhvillimin e sektorit, përparësitë e investimeve si edhe ndryshimet institucionale që kërkohen brenda Ministrisë për të siguruar një politikë-bërje dhe planifikim strategjik më të mirë. Përgatitjet në këtë fushë mbeten në një fazë fillestare.

Progresi në fushën e rrjeteve **trans-europiane** ka qenë i kufizuar. Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në zhvillimin e Rrjetit Rajonal të Transportit dhe në Observatorin e Transportit në Europën Juglindore (SEETO), veçanërisht me anë të miratimit të të parin Planin Pesëvjeçar të Përvitshëm 2006-2010 (MAP). Kërkohet të vazhdohet abshkëpunimi në kuadrin e SEETO-s, në kontekstin e rishikimeve vjetpr në mënyrë që të bëhet progres i mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimit e investimeve. Shqipëria duhet të sigurojë të transmetimin e të dhënave të plota për trafikun dhe transportin te rrjeti rajonal i transportit i SEETO-s.

Progresi në **transportin rrugor** ka qenë i kufizuar. Përparësitë kryesore për Qeverinë shqiptare mbetet përfundimi i Korridoreve Lindje-Perëndim (Durrës-Varna, nga Tirana dhe Sofia) Veri-Jug (që lidhet me Greqinë nga Mali i Zi). Megjithatë, ndërtimi i një segmenti të rëndësishëm të korridorit Veri-Jug, rruga nga Levani në Tepelenë e cila kërkon investime të mëdha të KE-së, Bankës Europiane për Investim dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ka vonesa serioze.

Hyrja në fuqi e ANTP-së i hap rrugën zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Aseteve Rrugore (RAMS), faza e parë e të cilit është një plan biznesi rajonal dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (GRD) do të bëhet agjenci, që kontraktin të gjitha aktivitetet e firmave private (kryesisht për mirëmbajtje rruge) e cila e ka potencialin për përmirësimin e efikasitetit.

Megjithatë, cilësia e mirëmbajtjes ka qenë e dobët, ku përparësimi dhe identifikimi i ndërhyrjeve mirëmbajtëse është bërë politikisht. Siguria rrugore vazhdon të jetë problem për shkak të kushteve të dobëta të rrugëve, sinjalistikës së mangët dhe kualifikimit të kufizuar të shoferëve dhe këmbësorëve. Ndërtimet e paligjshme vazhdojnë përgjatë rrugëve të reja, me implikime të rënda si për mirëmbajtjen e rrugëve, ashtu edhe për sigurinë rrugore. Një program urë për menaxhimin e asetëve që fokusohet në parandalimin e përkeqësimit të mëtejshme të strukturave urë, sidomos në rrugët e mëdha, është në fazën fillestare.

Progresi në **transportin hekurudhor** ka qenë tepër i kufizuar. Pas kundërshtimeve të bankës Botërore, Fondit Monetar dhe Bashkimit Europian, e sidomos të Qeverisë së re, nuk është ndjekur projekti për

e shërbimit hekurudhor midis Tiranës dhe Durrësit si dhe ndërtimi i një aksi lidhës me aeroportin e Tiranës. Megjithatë, sektori hekurudhor vazhdon të pterkeqësohet për shkak të kushteve ekstreme të shinave dhe vagonëve. Të dy raportet e ENTP-së dhe një në 2004 për modernizimin e Hekurudhës Shqiptare, rekomandonin mbylljen e sektorëve të caktuar të rrjetit dhe ndërprejen e shërbimeve deri në hartimin e një plani biznesi me ristrukturime thelbësore. Zhvillimi i këtij plani, dhe reforma e Hekurudhës Shqiptare, është duke u përgatitur.

Njëfarë progresi është bërë edhe në sektorin e **transportit ajror**. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Zonës së Përbashklët Europiane të Aviacionit (ECAA), Shqipëria ndërmoi angazhime për t'u integruar në tregun e aviacionit të BE-së dhe të aplikonte standardet e aviacionit të BE-së. Kjo do të kërkojë aplikimin në praktikë të marrëveshjes ECAA dhe zbatimin e shpejtë e fazës së parë transitore të pjesës përkatëse të *acquis*, përfshi kushtet e ekselit në treg, sigurinë, politikën aeroportuale, çështjet mjedisore dhe sociale si dhe kontrolli i trafikut. Ka filluar ndërtimi i një infrastrukture të re në aeroportin e Tiranës si edhe ka avancuar degëzimi i ri nga autostrada Tiranë-Durrës. Qeveria ka elemente të diskutshëm të marrëveshjes me konesion midis Qeverisë dhe operatorit të Aeroportit të Tiranës, pasi përfundimisht kërkon të përdorë aeroportin e ri në Kukës (i përfunduar po jo në punë) për fluturime ndërkombëtare, çka mund të bjerë ndesh me marrëveshjen e koncesionit.

Progres shumë i kufizuar është bërë në fushën e **transportit detar**. Për sa i përket privatizimit të operacioneve portuale, procesi po vazhdon në Vlorë dhe në Durrës për shërbimet e ngarkim-shkarkimit. Një Master Plan për Portin e Durrësit po zhvillohet. Përveçse tregon se si Durrësi duhet të zhvillohet, Plani do të shërbejë edhe si skicë për zhvillimin e përgjithshëm të porteve shqiptare, në përputhje me rekomandimet ANTP. Është planifikuar ndërtimi i një terminali trageti në Durrës, ashtu siç ka edhe përmirësime të infrastrukturës në Portin e Vlorës. Bilanci i sigurisë detare të Shqipërisë mbetet tepër i ulët. Progres i konsiderueshëm nevojitet në përmirësimin e nivelit të lartë të ndalimit të anijeve (detention rate) (23.36% në 2005) sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit.

Përgatitjet e Shqipërisë në fushën e rrjeteve trans-europiane, transportit ajror dhe detar, mbeten në një fazë fillestare. Përgatitjet në terren për transportin rrugor dhe hekurudhor po mbesin mbrapa.

4.2.5 *Energy*

Njëfarë progresi është arritur në fushën e energjisë. Për sa i takon stokut të naftës dhe sigurisë së ofertës, nuk është regjistruar asnjë progres. Shqipëria nuk mban stok të mjaftueshëm nafte. Prodhimi i qymyrgurit është i ulët (rreth 0.4 milion ton në vit) krahasuar me rezervat e llogarituta (mbi 700 milion ton)

Është miratuar i gjashti Plan Veprimi i Sektorit Energjetik. Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Komunitetit Energjetik dhe ka filluar miratimin e pjesëve përkatëse të *acquis*. Është rëndë dakord për një ulje të tarifave midis Kompanisë Shtetërore të Energjetikës (KESH) dhe Bankës Botërore dhe i është dorëzuar autoritetit rregullator. Një task forcë është ngritur nën Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të çuar më tepër ristrukturimin dhe privatizimin e sektorin elektrik.

Disa përmirësime janë bërë në lidhje me furnizimin kombëtar me energji pas krizën së fundit serioze që ndodhi në tremujorin e fundit të vitit 2005 dhe gjatë janarit të 2006-ës. Energjia u ble nga Rumania dhe Serbia dhe u transmetua nëpërmjet Serbisë. KESH-i miratoi një strategji për sigurinë e energjisë me anë të diversifikimit të burimeve, dhe kontrakttoi katër kompani të huaja. Nga fundi i tremujorit të parë 2006-ës, KESH ishte në gjendje të "ruante" energji të tepërt nga linjat me Kosovën, Greqinë dhe 2 shoqëri tregtare.

Megjithatë, humbjet dhe vjedhjet e energjisë elektrike u rritën gjatë tremujorit të parë të 2006-ës në nivele të ekzagjuara, ndërkohë që përqindja e mbledhjes së faturave ra sërish. Bashkë me shkurtimet e stafit që parashikohen para privatizimit përfundimtar, kjo e vë KESH-in në një pozitë të vështirë. Ka filluar ndarja e KESH-iut në tri ente të pavarura, dhe Operatori i Sistemit Transmtues është ndarë ligjërisht dhe financiarisht nga KESH, por procedurat e akordimit të fondeve po vazhdojnë akoma. Në përpjekje për të siguruar privatizimin e suksesshëm pas një përpjekjeje të dështuar, ristrukturimi i shpërndarësve rafinues dhe tregtues ARMO ka filluar tashmë. Asnjë progres i veçantë nuk është arritur në procesin e hapjes së tregut. Deri tani, vetëm dy kompanive u është dhënë statusi i Klientit të Ligjshëm. Legjislacioni kuadër dhe zbatues duhet të përmirësohet.

Qeveria ka konfirmuar planet e saj për të vazhduar me ndërtimin e një termocentrali të ri në Vlorë, ndërkohë që projektet e tjera të lidhura me Parkun Energjetik do të zhvendosen në Bisht Poro (??) dhe Porto Romano. Një tjetër projekt termocentrali parashikohet në Korçë.

Ligji shqiptar i Efiçencës Energjetike i prillit 2005 shtrun kuadrin ligjor për promovimin dhe përmirësimin e përdorimit efikas të energjisë në Shqipëri. Ligji krijon një fond për efikasitetin e energjisë. Qendra e Efiçencës Energjetike Shqipëri-BE vazhdoi të jetë e përfshirë në disa projekte pilot, përfshi një me trajnime për të përdorur energjinë diellore për ngrohjen e bolierëve të ujit. Përdorimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë prapë mbeten në nivele të ulëta.

Nuk është bërë progres për sa i përket sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Edhe pse ekziston një kuadër ligjor dhe strukturat themelore administrative, burimet njerëzore janë të pamjaftueshme dhe menaxhimi i mbetjeve radio-aktive dhe monitorimi i burimeve rrezatuese duhet të përmirësohen. Shqipëria do të duhet të sigurojë përputhshmërinë me kërkesat dhe procedurat e Traktatit Euroatom, veçanërisht në lidhje me monitorimin e mjedisit dhe mbrojtjen nga rrezatimi në ndërthurje me aplikimet mjekësore dhe industriale. Shqipëria ende nuk është anëtarësuar në “Konventën e Sigurisë bërthamore”, si edhe në “Konventën e Përbashkët për Sigurinë për Menaxhimin e Hidrokarbureve të Shuara dhe për Menaxhimin e Sigurisë nga Mbetjet Radioaktive”, tek të cilat Euratom ka qenë palë kontraktuese respektivisht që në prill 2000 dhe janar 2006.

Në përgjithësi, pavarësisht njëfarë progresi, sektori i energjetikës mbetet në një gjendje të mprehtë kritike që pengon zhvillimin soocial dhe ekonomik të vendit.

4.2.6 *Shoqëria e informimit dhe media*

Progresi ka qenë tepër i dobët në fushën e komunikacioneve elektronike dhe teknologjive të informimit. Masat legjislative për liberalizimin e tregut, duhet ende të respektohen dhe të zbatohen. Ligjet e reja ose të amenduara duhet të marrin parasysh kuadrin aktual të BE-së për shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik dhe shërbimet. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (TRE) duhet ende të përmirësojë organizimin e vet dhe kapacitetet. Nuk është aktiv sa duhet në zbatimin e legjislacionit në një mënyrë të pavarur, transparente dhe jo-diskriminuese dhe në ekzekutimin e vendimeve të veta. Në lidhje me privatizimin e Albtelecom, një rishqyrtim i jashtëm i urdhëruar nga qeveria për tenderin e privatizimit, nxori në pah një sërë problematikash proceduriale.

Shumë pak progres ka pasur në fushën e konkurrencës në këtë sektor. Ende nuk ka një ofertë të miratuar inter-konjeksioni apo një ofertë të kuotuar. Një rritje me 17% në tarifën e thirrjeve në vend është një hap i vogël drejt ri-balancimit, por hapa të mëtejshëm nevojiten.

Në lidhje me telefoninë celulare, operatori zyrtar dhe dy operatorë celularë janë përcaktuar si operatore me fuqi të konsiderueshme tregu (SMP). Pas këtij përcaktimi, marrëveshje të reja inter-konjeksioni janë nënshkruar midis operatorit fiks zyrtar dhe dy operatorëve celulare me uljen e tarifave të inter-konjeksionit që nga 1 gusht 2006, e miratuar nga Enti Rregullator. Vendimet për futjen e masave konkurruese dhe zhvillimin e konkurrencës në fushën e tregut të telefonisë fikse, kanë mbetur akoma pezull. Portali i numrave (number portability), si për telefoninë fikse edhe atë celulare, gjithashtu duhet të adresohet dhe të rregullohet. Përgatitjet për plotësimin e legjislacionit të nevojshëm dhe zbatimin e tij, mbetet në fazë fillestare në Shqipëri. Në fushën e gatishmërisë për të marrë angazhimet e MSA-në në sektorin e komunikacioneve elektronike, Shqipëria po mbetet shumë mbrapa.

Nuk ka zhvillima domethënëse për të raportuar në fushën e **shërbimeve të shoqërisë së informimit**.

Progresi i kufizuar është shënuar në fushën e **politikës audio-vizuale**. Amendamenti për emërimin dhe përbërjen e Këshillit Komëbtar të Radio-Televizionit (NCRT) dhe Bordit Drejtes të Radio-Televizionit Shqiptar (SCART) dhe mendimet për Ligjin për Informacionin e Klasifikuar, janë hapa pozitivë. Tre projekt-ligje ose amendamente që e vënë në linjë këtë legjislacion me Direktivën për Televizionin Pa Kufij dhe me Konventën Europiane për Televizionin pa Kufi, pritet të miratohen nga parlamenti. Ngritja e një Këshilli të Etikës në media është një hap pozitiv drejt përdorimit të vetë-rregullimit për të rritur profesionalizmin në media duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë editoriale (*shikoni edhe Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve*)

Megjithatë, një marrëveshje politike me kompromis në gusht 2006 mund të çojë në ndryshime të mëtejshme në NCRT dhe SCART si dhe zbatimin e saktë të procesit përzgjedhës mbett për t'u parë. NCRT ka nevojë për burimet e duhura njerëzore dhe financiare për të përmbushur detyrat e veta, sidomos për akordimin e frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar, parandalimin e zënies pirate të frekuencave, luftën kundër piraterisë në të drejtë e autorit dhe monitorimin e transmetuesve. Shqipëria duhet të miratojë ligjet kundër piraterisë në media dhe të rregullojë transmetimin dixhital në linjë me standardet e BE-së. Sjellja në linjë me Direktivën për Televizionin Pa Kufi, mbetet në një fazë fillestare. Shqipëria duhet gjithashtu që ligjet ezistuese mbi median, t'i zbatojë në përputhje me standardet e BE-së.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e shoqërisë së informimit dhe medias, por po mbeten mbrapa.

4.2.7. *Kontrolli financiar*

Njëfarë progresi është arritur në fushën e Kontrollit Të Brendshëm Financiar Publik (PIFC). Karta e Politikës 2005 PIFC është miratuar nga qeveria e re dhe është hartuar një plan veprimi. Gjithashtu është miratuar një manual për auditimin e brendshëm. Ka filluar puna për hartimin e një manuali të menaxhimit financiar. Programi kualifikues dhe procesi i certifikimit për audituesit e brendshëm në sektorin privat ka kontribuar në njohjen e auditimit si profesion dhe paraqiti envojën për kualifikim më të mirë të audituesve.

Pas miratimit të plan veprimit të Kartës së Politikës 2005 PIFC, duhet të miratohet një ligj i ri për auditimin e brendshëm që të jetë në linjë me standardet ndërkombëtare. Rishikimi i kuadrit ligjor, që përfshin aspektin e kontrollit të menaxhimit financiar të PIFC, mbetet në fazë fillestare dhe do të marrë në konsideratë strukturën përfundimtare dhe përbërjen e Ligjit Organik për Buxhetin, i cili vetë është nën rishikim. Rolet përkatëse të inspektimit dhe auditimit të brendshëm, mbeten për t'u sqaruar.

Njëfarë progresi është bërë në zhvillimin kuadrit ligjor dhe rregullator për Kontrollin e Menaxhimit Financiar (FMC) dhe Auditimit të Brendshëm (IA). Po vazhdon krijimi i kapaciteteve institucionale. Çështja e krijimit të një Njësie të veçantë të Harmonizimit Qendror (CHU) për FMC dhe IA, është adresuar së fundmi në kuptimin që Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm (GDPIA) është përgjegjëse tashmë vetëm për IA.

Megjithatë, çështja se si dhe kur do të ngrihet FMC/CHU, kjo mbetet për t'u zgjidhur. Krijimi i kapaciteteve institucionale ka akumuluar vonesa të mëtejshme dhe progresi është më i ulët nga ç'pritej në çështje si manualet e FMC-së dhe IA-së dhe masat e nevojshme legislative.

Për sa i takon auditimit të jashtëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka avancuar shumë në aktivitetet e veta audituese si edhe në menaxhemin e vet të brendshëm dhe organizimin. Kontrolli i Lartë (SAI) është tashmë në procesin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit për 2005-2008. Pavarësia e këtij institucioni është konfirmuar, përveç për sa i takon buxhetit. Kufizimet e imponuara ndaj operatorëve të Kontrollit në 2005, rezultoi në uljen e punës audituese për këtë vit.

Përgatitjet në fushën e kontrollit financiar janë nisur por janë në shkallë të pabarabartë.

4.2.7 *Statistikat*

Progres logjik është shënuar për sa i përket infrastrukturës statistikore. Ligji për Statistikat Zyrtare është tashmë në përputhje me standardet evropiane. Pjesa më e madhe e klasifikimeve kryesore janë në rregull, megjithëse më tepër punë nevojitet. Objekti i punës i regjistrimit të biznesit, duhet të zgjerohet. Programi 5-vjeçar i statistikave zyrtare 2007-2012 i jep INSTAT-it një rol qendror në përcaktimin dhe bashkërendimin e sistemit statistikor kombëtar. Për sa i përket sektorit të statistikave, Shqipëria ka bërë mjaft progress. Në lidhje me statistikave të biznesit, është realizuar një Antketim/Sondazh Strukturor i Biznesit. Po rishikohet pyetësi në mënyrë që mundësisht të përmbajë të gjithë treguesit sipas standardeve të BE-së. Përmirësimi i i ndjeshëm mbetet i nevojshëm si për statistikave afatshkurtra, ashtu edhe për statistikave strukturore të sektorit.

Për sa i tregon tregtisë me jashtë, konfirmohen prirje pozitive nga periudha e fundit e raportimit. Bashkëpunimi i mirë ka vazhduar midis INSTAT-it dhe administratës doganore për përpilimin dhe transmetimin e të dhënave elektronike drejt INSTAT-it. Të dhënat mujore për 2000-2005 janë përditësuar.

Për sa i takon statistikave të bujqësisë, është hartuar një pyetësor i përmirësuar për anketa të përvitshme, gjë që mundëson ndërtimin e burimeve dhe përdorimin e tyre për sektorin bujqësor. Nomenklatura përputhet me standardet evropiane. INSTAT gjithashtu po punon për përgatitjen e një Ankete/Sondazhi Strukturor Fermer në 2007 dhe për një Regjistrim të Popullsisë Bujqësore në 2008.

Në lidhje me statistikave demografike dhe sociale, nuk është raportuar ndonjë progres i veçantë. Në mënyrë që zhvillojë statistika demografike, Zyrat e Regjistrimit Civil duhet të marrin masa të mëtejshme për të siguruar regjistrimin e të gjitha evenimenteve demografike. Gjithashtu duhet të vendoset një regjistër popullate i bazuar në një regjistrim të popullsisë. Në fushën e statistikave rajonale, klasifikimi NUTS është zbatuar por vetëm në nivelin I (1 dixhit)

Në lidhje me statistikave makro-ekonomike, të dhënat PBB për 2003-2004 u publikuan në dhjetor 2005 duke përdorur si bazë metodologjike ESA 95. Megjithatë, progresi i mëtejshëm duhet të arrihet në fusha si shterrimi i PBB-së (exhaustiveness) PBB sipas tipit të shpenzimeve përfundimtare dhe përllogaritjet

tremujore të PBB-së. Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit është tashmë në përputhje të gjerë me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, por struktura e rënduar prapë ka nevojë për modifikime. Testimi dhe analiza e metodave u përmirësuan për hartimin e Llogarive Kombëtare Tremujore dhe tani përfshihen disa tregues të rëndësishëm që mungonin.

Nuk janë shënuar zhvillime të mëdha në fushat e infrastrukturës statistikore dhe klasifikimeve. Sistemi statistikor shqiptar po ecën përpara drejt përputhjes me standardet e BE-së, por kërkohet harmonizim i mëtejshëm, veçanërisht në statistikat makro-ekonomike, sociale dhe bujqësore. Regjistrat statistikore të biznesit dhe të popullatës, kanë nevojë të përditësohen.

Përgatitjet në këtë sektor kanë filluar.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1 Vizat. Kufiri, kontrolli, azili dhe migrimi.

Ka pasur njëfarë progresi në fushën e administrimit të vizave. Cilësia e trajnimeve për rojat e kufirit është rritur dhe trajnimet janë bërë edhe për lëshimin e vizave. Drejtoria Konsullore në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme dhe zyrat konsullore shqiptare jashtë shtetit, tashmë aplikojnë pulla vize me elemente sigurie, duke zëvendësuar sistemin e vjetër të vizave me stampë. Po përdoren pasaportat me vlefshmëri 10-vjeçare dhe me elemente sigurie, por puna për pasaportat e reja ku përfshihen të dhënat biometrike dhe një çip elektronik ka filluar dhe pritet të përfundohet nga fundi i 2006-ës.

Shqipëria ka marrëveshje të ndërsjella vizash me Malin e Zi (nuk kërkohet vizë), Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë. (vizë e lëshuar vetëm nga ambasadat). Shqiptarëve u duhet një vizë (e lëshuar vetëm nga ambasadat) për të hyrë në Kroaci, ndërkohë që kroatët s'kanë nevojë për vizë për të hyrë në Shqipëri. Shqiptarëve u duhet vizë (e lëshuar në kufi ose në ambasada) për të hyrë në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë, por shtetasit e saj s'kanë nevojë për vizë që të hyjnë në Shqipëri. Mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe, mbajtësit e pasaportave të shërbimit dhe diplomatike, s'kanë nevojë për vizë për të udhëtuar në vendet e lartpërmendura. Shqipëria e ka zgjeruar regjimin e lirë të vizave për Shtetet Anëtare të BE-së edhe për shtetasit e të gjitha Shteteve Anëtare që u anëtarësuan në BE në 2004.

Megjithatë, Shqipëria ende nuk ka amenduar Ligjit për Të Huajt dhe për ta sjellë në linjë me standardet e BE-së për vizat. Një rrjet i centralizuar IT (kompjuterik) dhe një bazë të dhënash (database) për administrimin e vizave, ende nuk jna ngritur. Progres i mëtejshëm nevojitet për të siguruar që lëshimi i dokumenteve të udhëtimit të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, siguria e dokumenteve të duplikuara (breeder??) dhe një sistem i besueshëm i regjistrat civil, janë të rëndësishëm në kontestin e pasaportave të reja me të dhëna biometrike të cilat Shqipëria planifikon t'i hedhë në qarkullim në fillim të vitit 2007. Përgatitjet në fushën e vizave janë në fazë fillestare.

Shqipëria ka bërë njëfarë progresi në fushën e **menaxhimit të kufijve**. Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e kontrolleve të emigrantëve dhe kontrollet në Pikë-kalimet Kufitare (BCP). Pajisje dhe logjistike e re kanë rritur efikasitetin e mbikëqyrjes së kufirit të gjelbër. Përdorimi i Njësive të Lëvizshme Mbikëqyrëse ka sjellë rezultate pozitive, veçanërisht në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe drogës. Instalimi i Sistemit Menaxhues të Informacionit Total dhe pajisjet përkatëse që bëjnë kontrollin e dokumenteve, ka përfunduar në 10 pikë-kalimet kryesore (BCP) dhe puna vazhdon edhe në pesë të tjera. Bashkëpunimi midis Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Drejtorive të tjera të Policisë Shtetërore Shqiptare (ASP) bashkë me homologët në vendet fqinje, është përmirësuar. Policia dhe strukturat e saj të kontrollit

kufitar kanë qenë shumë më aktive në parandalimin e kontrabandës së dhurve, cigareve dhe mallrave të tjera përmes kufijve të gjelbër, si edhe të emigrimit të paligjshëm drejt Greqisë. Qeveria ka ndërmarrë një moratorium 3-vjeçar kundër mjeteve lundruese të motorizuara, gjë që ka lehtësuar diktimin e aktivitetit kriminal në vijë ujore.

Numri i kalimeve të paligjshme të kufirit u rrit në fundin e vitit 2005. Kjo rritje ndoshta ka të bëjë me amnistinë për reziidentët e paligjshëm në Greqi.

Drejtoria e Policisë Kufitare dhe të Migrimit e ASP-së, ka rishikuar politikën e Menaxhimit të Kufirit sipas Udhëzimeve të BE-së për Menaxhimit e Integruar të Kufirit në Ballkanin Perëndimor, por kjo strategji ende nuk është miratuar. Ekziston një memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin midis policisë dhe shërbimit doganor, por detyrat përkatëse dhe përgjegjësitë e secilës palë ende s'janë të përkufizuara qartë.

Përpjekje të konsiderueshme kërkohen për të sjellë të gjitha BCP-të shqiptare konform standardeve evropiane për sa i përket pajisjeve teknike dhe trajnimit të stafit. Infrastruktura e dobët në portet e Durrësit dhe Vlorës, pengon kontrollin e përshtatshëm të kufirit dhe migrimit. Menaxhimi kufitar në këto porte dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, është ende jashtë standardeve ndrkombëtare. Mbikëqyrja e kufirit blu mbetet ende i dobët. Për shkak të mungesës së fondeve për të ngritur një Rojë Policore Bregdetare, forcat e ushtrisë përfshihen në kontrollin e kufirit dhe operacionet anti-kontrabandë. Kjo gjë nuk është në linjë me standardet evropiane, objektivat e partneritetit të NATO-s apo me angazhimet e Ohrit të ndërmarrura nga Shqipëria, të cilat kërkojnë komandë civile të agjencive të rendit me plotfuqi policore. Përkrah menaxhimit efikas të doganave, menaxhimi kufitar i Shqipërisë do të jetë i rëndësishëm për tregtinë në kuadrin e MSA-së dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme. Shqipëria pjesërisht i ka përmbushur objektivat në fushën e menaxhimit të kufirit.

Progres i kufizuar raportohet në fushën e **azilit**. Kuadri i përgjithshëm ligjor për azilin është nëpërputhje me standardet ndërkombëtare. Pajisjet për përpunimin e kërkesave për azil janë përmirësuar ndjeshëm dhe një proces para-skanues (pre-screening) tashmë është funksional. Të gjithë azil-kërkuesit dhe refugjatët tani pajisjen me dokumentet e nevojshme. Dy qendra strehimi janë ndërtuar së fundmi: një strehë për azil-kërkuesit dhe një qendër pritjeje kombëtare për viktimat e trafikimit në Shqipëri.

Drejtoria për Refugjatët dhe Kombësitë është nën procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Brendshme. Kjo ka bërë që vetëm 3 persona në personel të përpunojnë aplikimet për azil, në vend të pesë që ishin më parë, duke penguar kështu kapacitetet e Drejtuesit që të zbatojë planet e veprimit për azilin dhe që të përpunojë siç duhet aplikimet për azil. Duhet të zhvillohet një sistem efikas menaxhimi dhe duhet vlerësuar impakti i marrëveshjeve të ripranimit mbi kapacitetet e sistemit të azilit.

Nevojitet progres i mëtejshëm në zbatimin e kuadrit ligjor, vëçanërisht për sa i përket informimit të paditësve/pretenduesve për të drejtat e tyre, procedurën gjyqësore dhe përshtetimi i procesit të vendim-marrjes. Ligji për Të Huajt ende ka nevojë të harmonizohet me *acquis* dhe me ligjin për azilin. Kodi Penal dhe Kodi Doganor mbeten që të harmonizohen me dispozitat ekzistuese për kontrabandën. Informacionet për shtetin e origjinës ende mungojnë në procesin e para-skanimit dhe kjo e pengon Shqipërinë që të jetë në përputhje të plotë me *acquis* në fushën e azilit. Vëmendje i duhet kushtuar sigurimit me ekspertinë të përshtatshme për stafin që drejton qendrat e reja të azilit. Shqipëria vetëm pjesërisht përmbush objektivat në fushën e azilit.

Marrëveshje e Ripranimit KE/Shqipëri hyri në fuqi në 1 maj 2006. Kapacitetet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duhet të përmirësohen.

Njëfarë progresi raportohet në fushën e **migrimit**. Kuadri i përgjithshëm ligjor për migrimin, është në përputhje me standardet europiane. Shqipëria e ka përmirësuar koordinimin e brendshëm dhe bashkëpunimin me vendet fqinje në luftën kundër emigrimit të paligjshëm. Është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi midis Ministrisë së Brendshme dhe UNHCR, IOM dhe OSBE. Hapat e parë janë marrë drejt marrëveshjes së riprimit me Turqinë.

Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për politikën e migrimit, si edhe Protokollin Shtesë të Konventës ILO për punëtorët migrues. Emigrimi mbetet problem dhe strategjia kombëtare për migracionin e miratuar nga Qeveria në nëntor 2004 nuk ka prodhuar rezultate konkrete. Mungesa e stafit në Drejtorinë e Kufirit dhe Migrimit të Policisë Shtetërore Shqiptare, vë në rrezik aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur detyrimet e saj në kuadrin e marrëveshjeve të riprimit dhe për zbatimin e planit të veprimit për migrimin. Ende s'është ngritur një Agjenci për Migrimin. Emigracioni i paligjshëm drejt Greqisë vazhdon të përbëjë problem (edhe pse një protokoll bashkëpunimi me policinë kufitare greje dhe rojën bregdetare mund të ndihmojë) dhe Shqipëria vazhdon të jetë një vend tranzit për emigrantët ekonomike, azil-kërkuesit dhe personat e trafikuar. Shqipëria përmbush vetëm pjesërisht objektivat në fushën e azilit.

4.3.2. *Pastrimi i parave*

Progresi ka qenë i kufizuar në luftën kundër pastrimit të parave. Qeveria ka miratuar një projekt-ligj ku inkriminohet mbajtja e mallrave të vjedhura, që përbën një përmirësim të kuadrit ligjor për luftën kundër pastrimit të parave. Prokurori i Përgjithshëm ka ngritur një task forcë kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në Prokurorinë e Tiranës. Një agjenci për menaxhimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara është ngritur nën Ministrinë e Financave. Janë marrë disa hapa për rritjen e bashkëpunimit midis agjencive. Një komitet kombëtar për koordinimin e luftës kundër pastrimit të parave, i kryesuar nga Kryeministri, përfshin të gjitha institucionet përkatëse dhe mbledhet rregullisht. Grupi teknik i komitetit, Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU) e Ministrisë së Financave, tashmë mbledhet çdo muaj në zyrën e prokurorit.

FIU e ka shtuar stafin në 22. Katër çështje pastrimi të parave janë aktualisht në ndjekje penale. Tashmë është e domosdoshme që të hapet një hetim i aseteve për çdo hetim për krime të rënda.¹² Çështje për konfiskimin e aseteve nga krimi i organizuar, janë ndekur penalisht deri tani dhe tri kanë përfunduar me sukses. Hapa janë marrë për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Marrëveshja e rrjetit zbatues financiar (FINCEN) është nënshkruar me 25 shtete dhe marrëveshjet me shtetet e tjera janë duke u përgatitur.

Ekonomia e Shqipërisë vazhdon të bazohet gjerësisht në paranë dhe rrjedhimisht është vulnerabël ndaj pastrimit të parave. Kapacitetet për të zbatuar legjislacionin kundër pastrimit të parave, mbeten të dobëta. FIU ende nuk është e pajisur me një sistem funksional kompjuterik (IT) për raportimin e transaksioneve financiare. Nuk janë marrë hapa për rritjen e pavarësisë së FIU nga Ministria e Financave. Bashkëpunimi midis FIU-s, policisë dhe prokurorit, mbetet i dobët. Deri më sot nuk ka pasur qoftë edhe një procedim për mos-raportim. Amendime të tjera kërkohen për ta sjellë legjislacionin kundër pastrimit të parave në linje standardet europiane, me dyzet rekomandimet e Task Forcës të Aksionit Financiar 1990 për keqpërdorimin e sistemit financiar dhe nëntë rekomandimet speciale të 2001 për financimin e terrorizmit. Mbetet hapësira e konsiderueshme për përmirësime të mëtejshme në bashkëpunim me agjencitë e huaja të rendit për të hetuar rastet e pastrimit të parave (të rëndësishme sepse shpesh përfshihen rrjetet ndërkufitare).

Task forca kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit ende nuk është plotësisht funksionale për shkak të numrit të kufizuar të stafit të kualifikuar, dhe mungesës së një ndarjeje të qartë funksionale midis njësive të verifikimit dhe investigimit/hetimit. Nevojitet ende legjislacion zbatues për të trajtuar me efikasitet asetet e konfiskuara; dhe agjencia e re për menaxhimin e aseteve të konfiskuara ka staf shumë të pakët në numër.

Ende asnjë ndryshim nuk është bërë në prapësinë e lartë për ta bërë të detyrueshëm raportimin e e transaksionit. Është bërë progres shumë i pakët në futjen e mekanizmave të kontrollimit të parasë, dhe ato janë kufizuar vetëm në bordet njoftuese në aeroport. Niveli i raportimit dhe sekuestrimit është shumë i ulët dhe nuk pasqyron nivelin e parave që hyjnë e dalin nga vendi. Përgatitjet në fushën e luftës kundër pastrimit të parave, janë në fazën fillestare.

4.3.3. *Drogat*

Progres i lehtë është bërë në luftën kundër drogës. Me një nxitje më të madhe politike, u rrit pordorimi i mjeteve hetuese si për shembull dorëzimi i kontrolluar, blerjet e kontrolluara dhe mbikëqyrja, që kanë çuar në arrestimin e mbi 100 kundravajtëseve, midis tyre edhe për trafikim të drogës në sasi të mëdha nga bandat kriminale në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë, dhe me kapje të konsiderueshme kanabisi, hashashi, vaji hashashi, heroine dhe kokaine. Mbështetja me nisma të specializuara ndërkombëtare si PAMECA, ICITAP dhe INTERFORZA dhe bashkëpunimi intensiv dhe i frytshëm me INTERPOL-in, agjencitë e rendit të vendeve fqinje dhe me agjencitë e tjera të Shteteve të Europës Perëndimore, kanë kontribuar në këto rezultatet.

Shkrirja e Ministrisë së Rendit Publik dhe e Qeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme, i ka përmirësuar kushtet për bashkëpunim midis Policisë dhe oficerët e administratës vendore në luftën kundër trafikut të drogës. Amendimet e reja legjislative përfshijnë në luftën kundër kultivimit të drogës dhe zyrtarët e pushtetit vendor dhe i ngarkon ata me përgjegjësi ligjore nëse nuk raportojnë kultivimin e drogës në zonën e tyre. Policia ka hartuar një hartë të të gjitha zonave potenciale të kultivimit të bimëve narkotike. Shifrat e drogës së kapur janë bërë më konsistente dhe më të besueshme.

Megjithatë, sasi e drogës së kapur mbetet relativisht e ulët krahasuar me vëllimin e përlogaritur që trafikohet përmes Shqipërisë. Shqipëria duhet të zbatojë një plan veprimi të lidhur me Strategjinë Kombëtare Kundër Drogës dhe rekomandimet e Grupit Mini Dublin. Meqë përpjekjet e policisë janë përqendruar te kapja e heroinës dhe kanabisit, ka pasur pak progres në identifikimin e shkallës dhe natyrës së prodhimit në vend të drogave sintetike dhe tregtinë ndërkombëtare të drogave të tilla, por mendohet se tregu nuk është e i gjerë. Numri i të droguarve po rritet, por infraskrutura për trajtimin dhe informimin publik për këtë problem, është e mangët.

Kapacitetet dhe koordinimi për analiza të inteligjencës kriminale për të çmontuar rrjetet e trafikut të drogës, ende nuk janë optimale, dhe mund të përdorshin më tepër task forcat e përbashkëta anti-narkotikë ku të bashkëpunonin të gjitha autoritetet përkatëse shqiptare (p.sh. policia, prokuroria, gjyqtarët, Ministria e Financave dhe shërbimet sekrete).

Policia ende nuk ka procedurat e përshtatshme apo infrastrukturën për magazinimin, analizën dhe asgjësimin e drogave. Legjislacioni i ri që lejon përdorimin e makinave të kapura nga ana e policëve dhe prokurorëve sipas disa kushteve të caktuara, mbetet për t'u miratuar nga parlamenti. Përgatitjet në fushën e luftës kundër drogës kanë filluar.

4.3.4. Policia

Progresi ka qenë i mirë në fushën e **policisë**. Policia ka kryer një sërë operacionesh kyçe të suksesshme në muajt e fundit (*shikoni Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit*) dhe kanë kapur edhe sasi të mëdha armësh dhe municionesh.

Struktura e policisë po riorganizohet. Përmirësimi i profesionalizmit dhe bashkëpunimin janë demonstruar në punë në një skemë të re organizative që ta afrojë Policinë Shtetërore me shërbimet policore të Europës Perëndimore, e cila i është dorëzuar Ministrisë të Brendshme për miratim. Një grup pune po kodifikon përshkrimin e pozicioneve, detyrat dhe përgjegjësitë për të gjitha postet brenda policisë. Kanë filluar përpjekjet për përmirësimin e administrimit të të dhënave policore. Ka pasur disa emëtime të reja dhe transferime të stafit të vjetër të nivelit të lartë dhe të mesëm, por në përgjithësi stafi ka qenë i qendrueshëm. Trajnime profesionale janë organizuar për postet policore të të gjitha niveleve.

Ka filluar puna për një strategji 10-vjeçare për policinë dhe për një Ligj të ri të Policisë së Shtetit që duhet ta ndihmojë policinë që të plotësojë standardet evropiane, që pritet të finalizohet nga fundi i 2006-ës. Ligji i planifikuar do të përfshijë Ligjin aktual të Gradave dhe do t'i lejojë Drejtorit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme që t'i delegojë policisë menaxhimin e burimeve financiare. Klima objektive dhe monitorimi i vazhdueshëm i performancës për çdo komisariat policie dhe drejtori, ka pasur efekt dhe e ka mbajtur policinë në trysni që të përmbushë objektivat e marra përsipër. Është vendosur një bashkëpunim shumë më i mirë me shërbimin doganor dhe me Shërbimin Sekret Shtetëror.

Rritja e shpejtë e Tiranës dhe popullsia e saj heterogjene kanë çuar në rritjen e rasteve të grabitjeve të dhunshme apo vjedhjeve ordinere, dhe policia ende nuk po e mban ritmin e këtij zhvillimi demografik. Po t'i jepej një përparësi më e madhe pjesëmarrjes së publikut në denoncime, kjo mund të ndihmonte në adresimin e këtij problemi, por ende mbetet për t'u miratuar dhe zbatuar kjo strategji për komunitetin policor. Kërkohet bashkëpunim më i mirë me komunitetet vendore në mëbrë që të ulet përhapja e armëve që kontribuon në krimin në rrugë dhe dhunën e shkaktuar nga gjakmarrje, veçanërisht në veri të fundit.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve ende nuk përmbull standardet e kërkuara. Përmirësimi kërkon një koordinim më të mirë me Prokurorinë. Strukturat e menaxhimit dhe sidomos të kontrollit të brendshëm, kanë ende nevojë të forcohen. Menaxhimi i burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, duhet të kalojë nga Ministria e Brendshme te policia. Trajnime të mëtejshme dhe infrastrukturë është e nevojshme dhe një manual procedurash për të gjithë oficeret e policisë ende nuk është finalizuar për t'u bërë operues. Ende nuk është firmosur një marrëveshje strategjike me Europol-in, por është planifikuar fundin 2006/fillimin 2007. Përgatitjet në fushën e policisë po vazhdojnë.

4.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Progres është arritur në luftën kundër **krimit të organizuar**, një përparësi kyçe e Partneriteti Europian. Veçanërisht është vënë re përmirësim në përdorimin e legjislationit ekzistues për të luftuar krimin e organizuar. Vullneti i fortë politik për të shtypur krimin e organizuar, ka çuar në një sërë operacionesh policore kundër grupeve të mëdha kriminale dhe individëve që deri atëherë gëzonin një mos-ndëshkim thuajse të plotfuqishëm.

Progres është shënuar në zbatimin e Masave të Orientuara drejt Aksioneve Specifike kundër krimit të organizuar. Bashkëpunimi operativ nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese me organet e rendit të fqinjëve të

Shqipërisë (kryesisht me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën nën rregullorën 1244 KS) dhe shteteve të tjera, është përmirësuar shumë. Kanalet komunikuese me INTERPOL-in po funksionojnë mirë, duke rezultuar në arrestimet e disa të dyshuarve shumë të rrezikshëm që fshiheshin jashtë shtetit. Bashkëpunimi midis policisë dhe gjyqësorit në nivel qendror (veçanërisht me Drejtorinë e Krimit të Organizuar të SPA dhe me prokurorinë e Krimeve të Rënda) kundër krimit të organizuar, është përmirësuar disi siç tregohet nga arrestimet e mësipërme të personave tepër të rrezikshëm.

Ende shumë mbetet për t'u përmirësuar për të arritur rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, në kuptimin e përqindjes, numrit dhe cilësisë së procedimeve për shkeljet përkatëse si dhe për kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave/aseteve (proceeds of crime) të krimit. Lufta kundër korrupsionit në nivelet e larta të organeve të rendit, pengohet nga mungesa e një strategjie dhe e koordinimit midis drejtuesve të forcave të rednit dhe agjencive të ngarkuara me mbikëqyrjen e shpenzimeve publike, prokurimet dhe standardet e jetesës të funksionarëve publikë. Duhet të zgjerohet koncepti i një policie që udhëhiqet nga informacioni. Reforma sistematika në mënyrën se si policia bashkëpunon me gjyqësorin, sidomos në nivel vendor midis agjencive të rendit dhe prokurorëve të rrethëve, mund të përmirësonte edhe më tepër rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar. Një zgjidhje ligjore funksionale për koordinimin ndërmjet policisë, agjencisë shtetore të inteligjencës dhe prokurorisë, mungon akoma.

Më tepër punë kërkohet në mënyrë që komunikimi i drejtpërdrejtë dypalësh me INTERPOL-in për çështje specifike të krimit të organizuar, të funksionojë në mënyrë optimale. Ligjet shqiptare për mbrojtjen e të dhënave nuk janë të aplikueshme për policinë dhe prokurorët, dhe një autoritet i mbrojtjes së të dhënave ende s'ekziston, duke u bërë pengesë potenciale për shëmbimin e të dhënave me institucionet e huaja të rendit dhe përfundimin e një marrëveshjeve operative me Europol-in. Shqipëria duhet të bashkëpunojë më ngushtë me Europol-in që të japë input për vlerësimin e rrezikut të krimit të organizuar evropian dhe mbledhjen e informacioneve sekrete.

Përgatitjet në fushën e luftës kundër krimit të organizuar po vazhdojnë.

Njëfarë progresi mund të raportohet në fushën kundër **trafikimit të qenieve njerëzore**. Qveria e Shqipërisë vazhdoi me përpjekje të konsiderueshme për të luftuar trafikimin e njerëzve. Është shënuar një ulje e konsiderueshme e trafikimit të qenieve njerëzore me mjete lundrimi dhe gomone përmes detit Jon dhe Adriatik në dy vitet e fundit. Procedimet e suksesshme dhe ndëshkimet e trafikantëve kanë vazhduar. Përmirësimi i rrjetit kompjuterik (IT) në Ministrinë e Brendshme dhe në polici, ka kontribuar në diktimin dhe arrestimin e disa grupeve kriminale që kryesisht prodhonin pasaporta false dhe viza për në vendet Schengen, të cilat janë mjete kyçe për trafikim.

Qeveria ka emëruar një koordinator kombëtar me kohë të plotë për luftën kundër trafikut bashkë me një staf, dhe ka miratuar një Strategji Kombëtare kundër Trafikut. Është krijuar një Komitet Ndërmnistror Anti-trafik i kryesuar nga zv/Ministri i brendshëm. Qendra Anti-trafik në Vlorë është shkrirë në strukturat qendrore të policisë. Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe kundër trafikimit të fëmijëve me Greqinë dhe ka filluar të zbatojë ligjin e mbrojtjes së dëshmitarëve për viktimat e trafikut.

Trafikimi përmes kufijve shqiptare e fqinjët e Ballkanit Perëndimore, mbetet problematike. Kërkohen burime financiare e njerëzore si dhe masa të mëtejshme për të siguruar një koordinim efikas midis shërbimeve që operojnë në kufi. Rrjeti ekzistues i marrëveshjeve të bashkëpunimit operativ me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtare, duhet të zgjerohet.

Zbatimi i programeve të Qeverisë për mbrojtjen dhe parandalimin, mbetet i pjesshëm. Dobësitë në mbrojtjen e dëshmitarëve rezultojnë shpesh në frikë nga ana e viktimave që të dëshmojnë kundër trafikuesve të tyre. Ri-integrimi gjithëpërfshirës dhe shërbimet rehabilituese janë vendimtare në parandalimin e ri-trafikimit të viktimave. Hetimi dhe përndjekja e korrupsionit të lidhur me trafikimin në të gjitha nivelet e forcave të rendit, ende nuk është përcaktuar mjaftueshëm. Shqipëria vetëm pjesërisht i përmbush objektivat në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Shqipëria ka bërë njëfarë progresi në luftën kundër **terrorizmit**. Drejtoria e Kundër-Terrorizmit ka demonstruar përkushtim dhe motivim në parandalimin e akteve të rënda terroriste dhe ka kapur sasi të madha armësh, municionesh dhe lëndësh plasëse.

Sasia e madhe e armëve të kapura, mund të jetë një tregues i numrit të madh të armëve që mund të mbahen të fshehura ose në zotërim të bandave kriminale gati për t'i trafikuar ose përdorur. Zbatimi i legjislacionit në funksion të detyrimeve ndërkombëtare të ndërmara nga Shqipëria në parandalimin e terrorizmit, mbetet ende i paplotë. Bashkëpunimi midis agjencive vazhdon të jetë i dobët, dhe është nevojë për të qartësuar ndarjen e detyrave në luftën kundër korrupsionit dhe për të përmirësuar pajisjet dhe trajnimin për analistët dhe hetuesit e kundër-terrorizmit. Shqipëria pjesërisht përmbush objektivat në luftën kundër terrorizmit.

4.3.6. *Mbrojtja e të dhënave personale*

Për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve për sa i takon Përpunimit Automatik të Të Dhënave Personale dhe protokollin Shtesë për autoritetet mbikëqyrëse dhe fluksin e të dhënave ndërkufitare, në Shqipëri hyri në fuqi në qershor 2005. Megjithatë, Konventa nuk gjen zbatim për të dhënat personale të cilat janë të aksesueshme nga publiku dhe për të dhënat personale që publikohen në përputhje me ligjin.

Ligji aktual i mbrojtjes së Të Dhënave Personale, nuk është në linjë me *acquis*, konkretisht me Direktivën e Mbrojtjes së Të dhënave, sepse kryesisht ngaqë gjen zbatim vetëm për autoritetet publike. Një autoritetet mi pavarur për mbikëqyrjen e mbrojtjes së të dhënave me plotfuqi të mjaftueshme mbi sektorët publikë dhe privatë dhe me mjete të mjaftueshme, nuk është ngritur.

Kjo situatë bën që rregullat e mbrojtjes së të dhënave të mbeten tërësisht teorike dhe të mos zbatohen. Kjo është një çështje shqetësuese.